

Festivali Folklorik "I Këndojmë Lirisë" mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Klinës, prof. dr. Zenun Elezaj

LYRA



6, 7, 8 - Qershor 2025



23

VJET
FESTIVAL

REVISTË PERIODIKE E FESTIVALIT FOLKLORIK "I KËNDOJMË LIRISË"

NË ÇABIQ E KLINË, U MBAJT FESTIVALI MBARËKOMBËTAR "I KËNDOJMË LIRISË"

ÇMIMI I FESTIVALIT "MUJË KRASNIQI" SHKON NË SKENDERAJ



"Festivali "I këndojmë lirisë" është festival i kujtesës sonë kombëtare, festival i vlerave kombëtare, festival i traditave tona kombëtare. Njëjtë sikur Muja që i këndonte heronjve, luftërave, rapsodët me këngë, me çifteli, me sharki do ta kujtojnë Mujën, Alinë, dëshmorët e heronjtë e kombit, luftën e lavdishme të UÇK-së" ...

Prof. Dr. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës së Klinës



"Ky Festival është festë që përsëritet nga brezat e pas luftës, në Kosovën e lirë, gjithmonë duke ruajtur thelbin e tij – siç janë traditat, heroizmi, mikpritja dhe uniteti. Të bashkuar te kënga dhe tradita si një familje.

Kënga folklorike është zemra e lirisë sonë."

Prend Buzhala



Bashkimi kombëtar në Festivalin Folklorik "I Këndojmë Lirisë"

Intervistë ekskluzive me Ilir Shaqirin, këngëtarin e luftës dhe të lirisë

Komandant Mujë Krasnqi-Kapuçi, «Atdheu është më i shtrenjtë se jetët tona»!

Tri netët magjike të Festivalit Folklorik

BASHKIMI KOMBËTAR NË FESTIVALIN FOLKLORIK “I KËNDOJMË LIRISË”

Enver MALOKU

Festivali Folklorik “I Këndojmë Lirisë”, që mbahet në Klinë më 6, 7 dhe 8 qershor për çdo vit sjellë në skenë ansamble, grupe artistike, këngëtarë, valltarë, instrumentistë nga të gjitha trojet shqiptare. Këtu shpalosen vlerat e mirëfillta të folklorit tonë të pasur nga të gjitha trojet shqiptare. Kënga vallja, instrumentet, veshja, janë kombëtare, unicate. Të gjitha këto vinë që nga jugu i Shqipërisë, ajo e mesme, e veriut, Kosova, Presheva, Medvexha, Tetova, Dibra e Gostivari, Tuzi, Kalabria, diaspora e kudo tjetër ku ka shqiptarë. Këtu, në Klinë për tri net rresht është Shqipëria etnike. Këtu përmes këngës e valles bëhet bashkimi kombëtar. U këndohet të gjithë heronjve nga e gjithë shqiptaria ndër shekuj, nga krye heroit kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu e deri të Komandanti legjendar i UÇK-së Adem Jashari. Festivali folklorik mbarëkombëtar “I Këndojmë Lirisë”, përkon edhe me ditëlindjen e një ndër komandantëve më të shquar të UÇK-së, Mujë Krasniqit-Kapuçit. Ishte luftëtar i madh, njëkohësisht edhe rapsod, që krahas pushkës e kishte edhe çiftelinë, duke kënduar në front. Luftonte e këndonte për bashkim kombëtar. Thënia e tij gjeniale “Nuk po me interesojnë plagët e mia, por ku i ka kufijtë Shqipëria”, mbetet mesazh gjithnjë aktual për të gjitha gjeneratat. Armiku aq sa i frikësohej pushkës, po aq i frikësohej këngës. Kënga ishte kushtim për luftë kundër armikut për ta shpërrur nga trojet tona. Ashtu kishte ndodhur. Liria ishte fituar. Ajo është shumë e shtrenjtë, ashtu ishte paguar. Për këtë qëllim i këndohet asaj, vallëzohet për te. Kështu është edhe në Festivalin e Klinës, “I Këndojmë lirisë”. Shpatat dhe jataganët janë pjesë e koreografisë së festivalit. Sivjet është edicioni i 23-të i festivalit. Për çdo vit ka risi, vijnë vlera të çmuara e të pa përsëritshme. Kështu është edhe sivjet. Gjithçka është e drejtpërdrejt-lave. Në skenë për tri netët e festivalit, në skenën e përgatitur për këtë eviniment të folklorit gjithëkombëtar në skenë ngjiten rreth 700 këngëtarë, rapsodë, artistë e instrumentistë. Festivali ka karakter garues, kurse ndahen 15 çmime, kryesori është ai i “Mujë Krasniqit”, vendi i dytë, vendi i tretë, grupi më i kompletuar, veterani i festivalit, instrumentisti më i mirë, vallja më e mirë, koreografia më e mirë, e kështu me radhë. Gjithsesi karakteri garues i Festivalit Folklorik gjithëkombëtar “I Këndojmë Lirisë” e bën atë edhe më tërheqës, më interesant dhe sfidues për pjesëmarrësit në festival. Çdo edicion i festivalit sjell risi, vlera artistike. Kështu ishte edhe edicioni i sivjetmë, i 23-ti me radhë. Risi kishte si në sasi e cilësi. Për tri netë me radhë në skenë shpalosën vlerat e tyre artistë nga të gjitha trojet shqiptare. Edhe interesimi për ta përcjellë nga afër festivalin nga spektatorët ishte i madh. Kishte nga e gjithë Kosova, Ilirida, Lugina e Preshevës, Mali i Zi, diaspora e



trojet tjera ku ka shqiptarë. Festivali Folklorik “I Këndojmë Lirisë”, mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj. Moderatore e festivalit është Fatjona Gashi. Ndërkaq, për tri netë me radhë festivali u transmetua drejtpërdrejt nga Klina.info dhe RTK.

Redaksia:

Enver Maloku, kryeredaktor

Sadri Haxhaj, redaktor

Bedri Morina, gazetar-lektor

Rinor Berisha, fotograf

Taulant Berisha, design

Shtypshkronja "Blendi", Prishtinë



Në Çabiq të Klinës u hap Festivali Folklorik Mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë" TË BASHKUAR TE KËNGA DHE TRADITA SI NJË FAMILJE

Enver MALOKU, Sadri HAXHAJ, Bedri MORINA

Në Çabiq të Klinës, në vendlindjen e komandantit të shquar të UÇK-së, Mujë Krasniqi, pranë Kullës muze, solemnisht nisi edicioni i 23-të i Festivalit folklorik "I këndojmë lirisë", për të vazhduar për tri netë më radhë, me 6, 7 e 8 qershor në sheshin Mujë Krasniqi në qytetin e Klinës. Më këtë rast merrnin pjesë personalitete të shquara të jetës politike e ushtarake të Kosovës, bashkëluftëtarë të Mujës si dhe qytetarë të shumtë.



Festivalin e hapi kryetari Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, i cili, pasi që u ka dëshiruar mirëseardhje të gjithë të pranishmëve që kishin ardhur në Çabiq, në edicionin e 23-të të Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë", i cili tash e 23 vjet mbahet për të nderuar luftën heroike të komandant Mujë Krasniqi, "Kapuçit", dëshmorëve e heronjve të kombit, gjaku i të cilëve u bë themel i lirisë e pavarësisë së Republikës së Kosovës, Prof. Dr. Zenun Elezaj tha:

"Sot, këtu në Çabiqin e komandant "Kapuçit", në vendin ku Muja lindi më 6 qershor 1967, u rrit e u edukua në frymë atdhetare e patriotike e për tu bërë një ndër projektuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe një ndër luftëtarët më të zotë në luftën për liri e pavarësi, pikërisht

të, bashkë me ju, bashkëluftëtarë të Mujës, bashkëveprimtarë e bashkëvendës, po hapim edhe një edicion tjetër të Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar "I këndojmë lirisë", ndërsa festën që po nisim këtu do ta vijojmë për tri netë me radhë në Klinë, me kujtime dhe nderime të përhershme për luftën e UÇK-së", ka thënë Elezaj.

Ish-kryeministri i Kosovës, Ramush



Haradinaj, bashkëluftëtar i Mujës, tha se bashkëluftëtarët na bashkojnë në vendet e shenjtë, siç është Prekazi, Çabiqi e vende të tjera. Porosinë e luftëtarëve do ta çojnë vend. "Në këto manifestime nuk i harrojmë edhe bashkëluftëtarët tanë, ndaj të cilëve po zhvillohet procesi gjyqësor në Hagë. Atje do të dëshmohet pafajësia e Thaçit, Veselit, Krasniqi, Selimit e të tjerëve".

Në emër të fshatit Çabiq, ka folur Prend Buzhala, i cili fillimisht tha se Festivali "I Këndojmë Lirisë" është pjesë e festave të Klinës dhe Çabiqi, pjesë e kalendarit kombëtar e kulturor.

Të bashkuar te kënga dhe tradita si një familje.

Ky fshat, ndër festivale i pret me moton



"Mirë se ju ka pru Zoti. Shpia asht e mikut dhe e Zotit", ashtu siç është shtruar kjo sofër te kjo Kullë, nga e cila, dikur dëgjohej Kënga e Mujës dhe fluturonin Pëllumbat e Bardhë të Mujës.

"Çabiqi dha tre dëshmorë, Komandantin Mujë Krasniqi dhe të vëllain e Mujës, Ali Krasniqi, si dhe Muhamet Gashin, ndërkohe që sivjet u varros profesori i zhdukur gjatë luftës Adem Buzhala dhe vëllai i tij Ismeti, akoma i zhdukur. Çabiqi ka treguar gatishmëri për sakrificë, ka dhënë njerëz të artit e të krijimtarisë popullore e poetike", tha Buzhala.

Pastaj valltarët e valltare të Ansamblit "Jehona e Dukagjinit, interpretuan një valle tradicionale shqiptare me motive matjane. Në mbrëmje në Sheshin "Mujë Krasniqi" në Klinë vazhdoi festivali me grupet, këngëtarët, valltarët, pjesëmarrës të festivalit. Poashtu do të jetë i hapur edhe panairi me vendore. Festivali zgjatë tri ditë dhe ka karakter garues. Festivali Folklorik "I Këndojmë Lirisë", mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj. Moderatore e festivalit është Fatjona Gashi.



FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË KLINËS, PROF. DR. ZENUN ELEZAJ, NË FESTIVALIN FOLKLORIK "I KËNDOJMË LIRISË"



Të nderuar të pranishëm,
Mirë se keni ardhë në Çabiq në edicionin e 23-të të festivalit Folklorik Mbarëkombëtar "I këndojmë Lirisë", festival i cili tash e 23 vjet mbahet për të nderuar luftën heroike të komandant Mujë Krasniqit, "Kapuçit", dëshmorëve e heronjve të kombit, gjaku i të cilëve u bë themel i lirisë e pavarësisë së Republikës së Kosovës. Sot, këtu në Çabiqin e komandant

"Kapuçit", në vendin ku Muja lindi më 6 qershor 1967, u rrit e u edukua në frymë atdhetare e patriotike e për tu bërë një ndër projektuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe një ndër luftëtarët më të zotë në luftën për liri e pavarësi, pikërisht në ditëlindjen e tij të 58-të, bashkë me ju, bashkëluftëtarë të Mujës, bashkëveprimtarë e bashkëvendas, po hapim edhe një edicion tjetër të Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar "I këndojmë lirisë", ndërsa festën që po nisim këtu do ta vijojmë për tri netë me radhë në Klinë, me kujtime dhe nderime të përhershme për luftën e UÇK-së.

Të nderuar të pranishëm,
I nderuar mixha Halil,
Ky edicion i këtij festival zëmardh do të mbahet mend edhe për një arsye tjetër të rëndësishme. Këtë vit në mesin tonë mungon fizikisht një grua e cila e përkundër sakrificave e dhimbjeve të mëdha qëndroi gjithmonë si një heroinë e vërtetë. Ky është edicioni i parë që mbahet pa prezencën e Shehide Selimi Krasniqit, nënë e dy dëshmorëve të kombit, Mujë e Ali Krasniqit. Ajo sot nuk është fizikisht në mesin tonë, por ne do ta kujtojmë gjithmonë si grua e fortë, atdhetare, nënë heroinë e simbol i guas shqiptare.

Të nderuar të pranishëm,
Kemi thënë edhe në vitet e kaluara, se Festivali "I këndojmë lirisë" është festival i kujtesës sonë kombëtare, festival i vlerave kombëtare, festival i traditave tona kombëtare.

Njëjtë sikur Muja që i këndonte heronjve, luftërave, rapsodët me këngë, me çifteli, me sharki do ta kujtojë Mujën, Alinë, dëshmorët e heronjtë e kombit, luftën e lavdishme të UÇK-së.

Gjatë ditëve të këtij festivali, i cili, për nga përmasa folklorike është epope

kombëtare, do t'i kujtojmë dhe nderojmë të rënë të gjallët, plagëve e tyre për të shtrenjtën e të çmueshmen tokën tonë. Do t'u përkulemi të rënëve e do t'u gjendemi pranë familjarëve të tyre jo për t'u dhënë forcë, se kanë mjaftueshëm, por për të marrë forcë prej tyre dhe mësim se si, në kohë lufte, duhet t'i dilet zot vendit.

Më lejoni t'jua përmend dhe t'jua kujtoj, se Festivali "I këndojmë lirisë" ka karakter garues. Në këtë festival jepen 15 çmime. Çmimi kryesor është "Mujë Krasniqi", pastaj jepet çmimi për vendin e dytë, të tretë, për grupin më të kompletuar, për veteranin e festivalit, për instrumentistin më të mirë, për vallen më të mirë, për koreografinë më të mirë dhe çmime të tjera jo pak të rëndësishme.

Për tri ditë me radhë juria profesionale e festivalit përcjell me vëmendje garuesit dhe pastaj bën vlerësimin profesional. Përpos karakter garues, festivali ka karakter edhe promovues. Promovohen libra, organizohen tryeza shkencore, ekspozita, panairë me prodhime vendore bujqësore, me artizanale, edhe gara në disiplina të ndryshme sportive.

Ndihem jashtëzakonisht mirë që përballë dhe përbri jush, mes njerëzve të dashur të atdheut dhe të kulturës, sërish i këndojmë lirisë.

Jetë të gjatë festivalit dhe mbarësi juve!
Qoftë i përjetshëm kujtimi për heronjtë e UÇK-së!

Lavdi të gjithë të rënëve për çlirimin e Kosovës!

Mirë u takofshim në edicionin e radhës!



Nata e parë konkurruese në Festivalin Folklorik "I Këndojmë Lirisë" **KËNGË E VALLE NGA TREVAT E KOSOVËS**

Enver MALOKU,
Sadri HAXHAJ, Bedri MORINA



Sheshi "Mujë Krasniqi" në Klinë ishte i vogël për ti zënë të gjithë adhuruesit e këngës dhe valles burimore që kishin ardhur për ta përcjell nga afër Festivalin Folklorik mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë". Aty pranë shtatores së Komandantit Mujë Krasniqi-Kapuçit, në binën e ngritur enkas për këtë ngjarje folklorike, në skenë u paraqitën këngëtarë, valltarë e instrumentistë nga trevat e Kosovës. Edicionin e 23-të e hapi i pari Komunës së Klinës, kryetari Prof. Dr. Zenun Elezaj, ashtu siç e do rendi, duke u dëshiruar mirëseardhje e suksese të gjithë festivalistëve që marrin pjesë në këtë manifestim folklorik. Para nisjes së konkurrimit për të pranishmit u shfaq një video incizim me pamje të luftës dhe të këngëve të Mujë Krasniqit, me regji të Alban Gashit e me muzikë të zgjedhur nga Arjon Gashi. Moderatore e

festivalit është Fatjona Gashi. Në skenë, jashtë konkurrencës u ngjitën këngëtarët dhe valltarët e AKV "Jehona e Dukagjinit". Vëllezërit Halil e Dren Gashi kënduan për Mujën dhe Beqën, ndërsa valltarët e këtij ansambli u paraqitën me një valle me motive matjane.

Në natën e parë konkurruese, të parët që u paraqitën para publikut ishin këngëtarët dhe valltarët e SHKA "Malësori" nga Gjonaj i Hasit. Ata besnik, si kurdoherë i mbesin këngës dhe valles nga treva e Hasit. Vallja hasjane ishte një valle karakteristike, për veshjen unikate që i veçon nga të gjitha trojet shqiptare dhe për mënyrën hedhjes së valles nga valltarët e kësaj shoqërie artistike.

Ky grup u paraqit edhe me këngën "Kosovë trimja po çon fjalë." "Flaka e Llapit" nga Podujeva u paraqit me këngë të anës së Llapit. Rapsodët e Mleçanit, të përfaqësuar nga vëllezërit Kryeziu, si gjithnjë i mbeten besnik këngës së trevës së Llapushës. Karakteristike ishte paraqitja e SHKA "Opoja" nga Opoja e Dragashit, sidomos vallet e burrave dhe të vajzave të kësaj treve. Vallja e vajzave shoqërohej me këngë nga të gjitha valltarët, e përcjellë edhe me def. Ky grup u paraqit me vallen tradicionale të Opojes "Vallja e pehlivanëve", e njohur e këtij grupi që ishte tradicionale, kombëtare e kësaj ane, për mënyrën e luajtjes. Madje edhe kur këndohej në valle nga vajzat, përdorej gjuha karakteristike e trevës së Opojes, ashtu siç flitet, "djali i



dadës gji po ban". AKV "Karadaku" nga Gjilani u paraqit me këngën "Thërret Prizreni mori Shkodër". Ky ansambël përformoi edhe me një valle me pushkë e me ndezjen simbolike të një zjarri. Ishte një valle dyshe. AKV "Bilbilat e Pashtrikut", kësaj here kishin ardhur me një valle instrumentale dhe me një këngë për Mujë Krasniqin. Rapsodi Shefqet Gashi, këndoi për Bajram Currin. AKV "Selman Kadria", si zakonisht paraqitjen e tyre e fillojnë me vallen e Podgurit, duke vazhduar me performanca që askush tjetër nuk i ka, me melodi me gjeth, e njohur që nga kohërat e lashta. Ky ansambël nuk e lëshon nga dora e nga zemra lahutën. E jona thonë është. Këtë e konfirmuan edhe sonte me këngë duke kënduar për lahutën "Lahutën mos me e harru, me i ra e me i kënu, Brez pas brezi kem me kënu me lahutë për UÇK", janë vargjet e shkëputura nga kënga e këtij ansambli për lahutën. E preferojnë edhe vallen "Moj Hatixhe n'shami t'kuqe". Natën e parë e mbylli SHKA "Karadaku" nga Gjilani. Interesimi për ta përcjellë festivalin nga qytetarët e Klinës dhe më gjerë ishte i madh.



Nata e dytë konkurruese e Festivali Folklorik "I Këndojmë Lirisë"

NATA E DYTË NË SHENJË TË ARTISTËVE TË KOSOVËS DHE TË SHQIPËRISË

Enver Maloku
Sadri Haxhaj Bedri Morina

Në natën e dytë konkurruese të Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë" u prezantuan vlera të mirëfillta folklorike nga Kosova, Shqipëria e Diaspora. Në skenë u prezantuan artistë me një kolorit të veshjeve të ndryshme artistike nga mbarë trevat shqiptare. Festivali nisi me përformimin e artistëve nga Puka të cilët u paraqiten me një këngë për komandantin Adem Jashari. Për herë të parë në festival është prezantuar edhe një poezi po nga ky grup, me titull "Mujë Krasniqi lart në qiell". Festivali ka vazhduar me grupin "Studio Fenix" nga Diaspora, përkatësisht nga Zvicra, të cilët për dallim nga prezantimet tjera, ata u paraqitën me një valle me motive lufte, "I mbijetuari shqiptar ndër shekuj", për të cilën u duartrokiten nga masa e gjerë. Paraqitja e radhës ishte nga grupi polifonik nga Berati më saktësisht "Qypërlinjtë" nga rrethi i po këtij

qyteti, të cilët në skenë u prezantuan me një këngë për komandant Mujë Krasniqin. Ata shfaqen edhe disa interpretime me klarinetë me motive labe.

SHKA nga Obiliqi, u paraqit në skenë me dy këngë të kënduara nga këngëtari Vesad Mjeku, kurse rapsodët nga Krojmiri i Shalës u paraqitën me një këngë për dëshmorët e këtij fshati.

Në natën e dytë në skenë u ngjitën edhe rapsodët nga Deçani, si dhe SHKA "Isa Boletini" nga Rogova e Hasit..

Skena më pas i ka takuar ansamblit "Drenica" nga Skenderaj, të cilët u prezantuan me tri këngë dhe një valle të quajtur "Okarina" e cila u prezantua si premierë në këtë festival, që ishte brilante.

Ndërkaq, në natën e dytë përformuan edhe AKV "Hareja" nga Prizreni, të cilët u shfaqën në skenë me një valle burimore, tradicionale nga veteranët e këtij grupi, pastaj këngëtarja Hanë Hoxha u paraqit me këngën "Heroi im".

Nata e dytë garuese përfundoj me prezantimin e rapsodi nga Klina Emin Raci, që jeton në Zvicër.

Ndonëse në natën e dytë të festivalit, në të njëjtin termin transmetohej në televizion ndeshja futbolistike Shqipëri-Serbi, interesimi për ta përcjellë festivalin ishte i madh. Fatjona Gashi bëri në moderim mbresëlënës të festivalit.



Në Klinë ka përfunduar Festivali Folklorik mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë"

"DRENICA" E SKËNDERAJT" FITON ÇMIMIN "MUJË KRASNIQI"

Enver MALOKU



Ansambli i Këngëve dhe i Valleve "Drenica" e Skënderajt nga juria profesionale është shpallur fitues i edicionit të 23-të të Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë", i cili për tri netë me radhë u mbajt në Klinë. Vendin e dytë e mori Ansambli Autentik Folklorik "Rugova", ndërsa atë të tretin SHKA "Malësori" i Gjonaft të Hasit. Të tri këto çmime i ndanë kryetari Komunës së Klinës Prof. Dr. Zenun Elezaj dhe Halil Krasniqi, babai i heronjve Mujë e Ali Krasniqi. Çmimin e publikut e fitoi Grupi "Feniks" nga Zvicra. Poashtu, juria profesionale e festivalit në përbërje, prof. Xhevdet



Gashi, kompozitor, prof. Suzana Drenica, koreografe dhe prof. dr. Kushtrim Jakupi, muzikolog ndau edhe 12 çmime të tjera, si atë të grupit më të kompletuar, veterani i festivalit, veshja më e mirë, e të tjerë. Xhevdet Gashi, kryetar i jurisë tha se kjo ditë është folklorike, dhuratë e traditës sonë të pasur folklorike. Diferencat ishin shumë të vogla ndërmjet grupeve artistike që u paraqitën në skenë.

Nata e tretë ishte me vlera të larta që u prezantuan. "Kastriotët" e Ferizajt ishin të kompletuar. Grupi i Shkupit, para publikut interpretoi këngë të rrethit të Shkupit, ndërsa rapsodët Naim e Sali Bytyçi morën edhe duartrokjet e edhe çmimin e duetit më të mirë. Grupi "Besa" i Shkodrës mori duartrokitje për këngën "Mirë se t'gjeta mori Klinë", sikundër edhe grupi Burrave të Mirditës. Grupi polifonik i Tiranës është mirëpritur për nivelin e këndimit të këngëve polifonike. "Shotë Galica" e Drenicës, si gjithnjë në nivel. AKV "Anamorava" e Vitisë, u dallua për vallet e vajzave.

Ndezja e fishekzjarrëve, shënoj mbylljen e festivalit, që vërtetë ishte festiv. Festivali është mbajtur nën përkujdesjen kryetarit të Komunës, prof.dr. Zenun e Elezajt. Kontribut kanë dhënë të gjithë të tjerët, që nga Këshilli organizativ, drejtori komunal i kulturës Driton Bardheci, drejtori i Festivalit Alban Gashi, drejtorja artistike, grupi i gazetarëve dhe gjithë të tjerët. Moderatorja e festivalit, Fatjona Gashi ka lënë përshtypje të mirë.



Drejtori i DKRS-së, në Komunën e Klinës, Driton Bradheci

FESTIVALI "I KËNDOJMË LIRISË" – NJË HIMN PËR ATDHEUN, NJË NDERIM PËR HEROIN, MUJË KRASNIQI

Sadri HAXHAJ



Në zemrën e Kosovës, aty ku historia flet me gjuhën e këngës dhe kujtesa gjallërohet përmes valleve, ngrihet çdo vit festivali më i madh folklorik – "I Këndojmë Lirisë".

Ky festival nuk është vetëm një ngjarje kulturore; ai është një përkulje shpirtërore përpara sakrificës, një përqafim i rrënjëve tona dhe një himn për të gjithë ata që derdhën gjakun për lirinë që sot e gëzojmë.

Këtë vit, si çdo herë, festivali i është kushtuar njërit prej bijve më të denjë të kombit – heroit, Mujë Krasniqi. Ai që u bë simbol i guximit dhe dashurisë së pashoq për atdheun, që la pas jetën për të na dhënë një të ardhme më të ndritur. Në çdo tingull të çiftelisë, në çdo hap të valltarëve dhe në çdo strofë të këngëve të moçme, dëgjohet jehona e emrit të tij.

Drejtori i Kulturës, Driton Bardheci, thekson se *"ky festival është më shumë se një aktivitet artistik – është një betim i vazhdueshëm për të mos e harruar kurrë rrugën e gjakut dhe të lavdisë. Nëpërmjet tij, i këndojmë jo vetëm lirisë, por edhe dinjitetit dhe krenarisë sonë si popull."*

Komuna e Klinës, përmes Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, ka bërë me kohë të gjitha përgatitjet në mënyrën më të mirë të mundshme për mbarëvajtjen e këtij festivali, të cilat u treguan të suksesshme, për shkak se festivali ishte i suksesshëm. Organizimi profesional, angazhimi i stafit dhe bashkëpunimi me komunitetin kanë bërë që çdo detaj të jetë në nivelin më të lartë.

Hapja solemne e festivalit në fshatin Çabiq, vendlindja e heroit Mujë Krasniqi, ishte një ngjarje emocionuese që preku zemrat e të gjithëve, ndërsa

netët garuese në qytetin e Klinës u zhvilluan në një atmosferë të mrekullueshme, duke u dalluar për mënyrën e organizimit dhe për cilësinë artistike të pjesëmarrësve.

Festivali mbarëkombëtarë "I Këndojmë Lirisë", është pasqyrë e shpirtit shqiptar – fisnik, i pathyeshëm dhe i bukur në rrënjët e tij. Është festa ku gjaku bëhet këngë, dhimbja bëhet krenari, dhe kujtimi – frymëzim për brezat që vijnë.

Drejtoria artistike e Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë"

CILËSIA, KRITER

Sadri HAXHAJ

Drejtoria artistike e Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë", në përbërje Halit Gashi, drejtor, Daut Gashi anëtar, Fatmir Berisha anëtar, që nga koha e nisjes së aktivitetit për festival, aktivisht është marrë me përzgjedhjen dhe seleksionimin e grupeve artistike, ansambleve, rapsodëve, valltarëve e instrumentistëve që marrin pjesë në festival.

Drejtoria Artistike ka bërë përzgjedhjen e tyre duke respektuar kriteret e festivalit, cilësinë, moshën dhe vlerat të tjera. Kriteret janë muzikë e mirëfillt burimore folklorike që përkon me festivalin.

Kënga nuk mund të jetë më e gjatë se pesë minuta, e grupet konkurruese nuk mund ta tejkalojnë kohën më shumë se 15 minuta.

Festivali përkon edhe me ditëlindjen e Komandant Mujë Krasniqit - Kapuçit. Edhe sivjet interesimi ishte i madh për pjesëmarrje në festival, nga ansamblet, grupet e rapsodët nga të gjitha trojet etnike shqiptare dhe nga diaspora.



Flet drejtori i Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë", Alban Gashi

FESTIVALI KA ARRITUR NIVEL TË LARTË ARTISTIK

Enver MALOKU



Alban Gashi, tash e disa vjet është drejtor i Festivalit Folklorik "I këndojmë Lirisë". Për këto vite sa ishte në krye të këtij festivali, Gashi thotë se është përpjekur që festivali nga viti në vit të shënojë arritje. "Në secilin festival bashkë me drejtorinë Artistike kemi sjellë grupe nga të gjitha trevat etnike. Kështu që për tri netët e festivalit në Klinë është e gjithë shqiptaria, nga Kosova, Shqipëria, Shkupi, Tetova e Gostivari, Presheva e Medvegja, Mali i Zi, Kalabria e diaspora. Për çdo vit ka risi, ka cilësi e kolorit këngësh e vallesh. E gjithë kjo ka bërë që të jemi në nivel të punëve, detyrave, angazhimeve e të përgjegjësisë. Për këtë arsye ne me kohë i fillojmë përgatitjet, bëjmë ndarjen e detyrave, jo vetëm në Klinë ku zhvillohet festivali, por edhe në Çabiq, vendlindjen e komandant Mujë Krasniqit-Kapuçit, ku nis edhe festivali, poashtu me një program artistik dhe me shtrimin e sofrës tradicionale", shprehet Gashi. Ai thekson edhe risitë që ishin në edicionin e sivjetmë të 23-in me radhë. Kështu sivjet për herë të parë në skenë ishte vendosur një monitor, panot dhe pamjet në ekran. Poashtu sivjet është përgatitur një video incizim me pamje e zë origjinal të Mujë Krasniqit e Beqir Gashit, të xhiruara në periudhën e luftës (1998). Kam ndjenjë e kënaqësi të veçantë që i takoj fshatit Çabiq, vendlindjes së Mujë Krasniqit", thotë Gashi.

PANAIR I PRODUKTËVE VENDORE DHE ARTIZANALE

Sadri HAXHAJ

Në Klinë, u hap panairi me produktet vendore dhe artizanale nga prodhuesit vendor nga Klina dhe më gjerë.

Hapjen e kësaj ngjarjeje e ka bërë kryetari i komunës së Klinës, Zenun Elezaj bashkë me drejtorin komunal të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Lorenc Marleku.

Drejtori komunal i Bujqësisë, Lorenc Marleku, tha se këtë vit po marrin pjesë 15 kompani të ndryshme nga e mbarë Kosova, derisa u shpreh i kënaqur me interesimin e prodhuesve vendorë. Ai bëri thirrje që në organizimet e ardhshme të bëhet stimulimi me mjete financiare për të gjithë të interesuarit ngase në këtë mënyrë i rritet vlera këtyre organizimeve.

Njëri nga pjesëmarrësit e këtij panairi Lorenc Kqiraj, u shpreh i kënaqur me këtë pjesëmarrje sepse sipas tij organizimet e tilla po kontribuojnë në promovimin e prodhimeve vendore.



Kryetari i Organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, Hajdin Balaj **FESTIVALI FOLKLORIK "I KËNDOJMË LIRISË", PERSONIFIKIM I UÇK-së**

Sadri HAXHAJ



Organizatat e dala nga lufta, aktivisht marrin pjesë në organizimin e Festivalit folklorik "I Këndojmë Lirisë" në nderim të figurës së komandantit, Mujë Krasniqi.

Hajdin Balaj, kryetar i OVL-së në Klinë, thotë se sa herë që vjen festivali, ndjejnë nostalgji për komandant Mujë Krasniqin, i cili ishte krenaria, jo vetëm e luftës sonë për liri, por edhe mbarë kombëtare.

Balaj, shprehet se deri më tash nuk është bërë sa duhet për dëshmorët e kombit, familjarët e tyre, invalidët dhe veteranët.

"Dëshmorët janë më meritoret, sepse falë gjakut të tyre për liri, luftës së UÇK-së, ne sot festojmë të lirë", tha Balaj. Ai po ashtu shprehu zhgënjimin dhe pakënaqësinë që edhe këtë festival e mbajtëm pa praninë e krerëve të UÇK-së, që po mbahen padrejtësisht në Hagë, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Lufta e UÇK-së ishte e pastër dhe e drejtë, siç do të jetë edhe pafajësia e luftëtarëve të lirisë", thotë Balaj.

Bisedë me Fatjona Gashin, moderatore e festivalit

NDJENJË E VEÇANTË TA MODEROSH FESTIVALIN

Bedri MORINA

Fatjona Gashi, ish drejtoreshë komunale e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që sivjet është edhe moderatore e Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë", flet për periudhën sa ishte në krye të kulturës, si dhe për përzgjedhjen e saj për ta moderuar festivalin e sivjetmë.

"Në drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit por edhe në përgjithësi në Komunën e Klinës, ngjarja më e madhe kulturore është festivali folklorik "I këndojmë Lirisë", ndaj si përvojë për mua do të kujtohet gjithmonë si ngjarje e mbushur përjetime të veçanta, punë e bashkëpunime të vazhdueshme. Mysafirët e grupet e shumta artistike nga të gjitha trojet shqiptare dhe më gjerë, vallet e këngët e bukura shqipe, veshjet e veçanta me motive kombëtare, skena e festivalit e mbushur plot vlera, përkujtimi e nderimi i figurës së Mujë Krasniqit - Komandant "Kapuçit" dhe të gjithë Dëshmorëve të Kombit, patjetër që kanë lënë gjurmë tek unë që do t'i ruaj me nostalgji në sirtarin e përjetimeve të bukura si ish-drejtoreshë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit", thotë Gashi.

Ndjenjë e veçantë, kënaqësi kur sheh një publik kaq të madh që vazhdojnë ndër vite të jenë të pandashëm nga festivali, t'i duartrokasin e t'i vlerësojnë grupet artistike me plot entuziazëm, t'i dhurojnë frymë festive sheshit "Mujë Krasniqi", në Klinë.



EMIN RACI, 15 VJET BASHKËKËNGËTAR ME MUJË KRASNIQIN

Enver MALOKU



Rapsodi i njohur, Emin Raci, nga Siçeva e Klinës, që më tepër se tri dekada, jeton dhe vepron në Zvicër, pasion e ka këngën

folklorike. Ai qysh si fëmijë e donte këngën, e donte çiftelinë e sharkinë, të cilat kurrë s'i lëshoj prej dore. Zëri tij e tingujt e çiftelisë ishin bashkë. Emini, që nga bankat shkollore në Ujmirë të Klinës, pasion dhe përkushtim e kishte këngën, si atë folklorike por edhe ate popullore. Këtë dëshirë për këngën e ka vazhduar edhe kur migroi në Zvicër dhe vazhdimisht këndon pa u ndalur kurrë, në ahengje, festa të ndryshme kombëtare e shtetërore, më 28 Nëntor, ditën e Flamurit apo më 17 Shkurt, ditën e shpalljes së pavarësisë së shtetit të Kosovës. Ai asnjëherë nuk merr para për këto ditë të shënuara. Emin Raci vazhdimisht merr pjesë në Festivalin folklorik mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë", që mbahet çdo vit në Klinë, më datat 6,7 e 8 qershor, që i kushtohet Komandantit të shquar të UÇK-së Mujë Krasniqit-Kapuçit e luftëtarëve të tjerë të lirisë. "Mujën e Beqën i kisha shokë të shpirtit, ndaj edhe nuk e lëshoj asnjë festival.

Për çdo vit vij bashkë me familje, me gëzimin më të madhe dhe mallin e pashuar për Mujën e Beqën. Shpesh marr çmimin e diasporë, që e kam për zemër këtë çmim, por asnjëherë nuk vij për shpërblim apo çmim. Më pëlqen pjesëmarrja, kur shoh këtu në festival nga të gjitha trojet shqiptare, nga Shqipëria, Ilirida, Presheva, Tuzi e Malësia, nga trojet e arbëreshëve e të tjerë", shprehte i emocionuar Raci. Ai preferon këngë patriotike, për ushtarët e UÇK-së, trimat e lirisë, për Mujën, Beqën Aliun. Emini i kthehet me nostalgji kur këndonte herët në rini me Mujën. "15 vjet kam kënduar bashkë me Mujën, më së miri me shkante zëri me te. Këndonim edhe në dasma, e tubime të ndryshme, por edhe në oda e ndeja të ndryshme. S'kishte si Muja", kujton me emocion Emini. I pëlqen atmosfera në festival, ndaj edhe pushimin e rezervon për çdo vit në muajin e qershorit, kur edhe mbahet festivali. Nëna e donte shumë, i thoshte i vogli.

Bisedë me Kastriot Kolën, udhëheqës artistik i ansamblit "Mirdita"

NË KLINË KA GJYSMËN E FISIT TË TIJ

Bedri MORINA

Në Festivalin Folklorik "I Këndojmë Lirisë" për herë të dytë po marrin pjesë edhe grupi i burrave nga Mirdita. Udhëheqësi i këtij grupi, Kastriot Kola, flet me admirim të madh për organizimin e këtij festivali si dhe mirëpritjen që bëjnë qytetarët e Klinës.

"Ansambli Mirdita është themeluar para 73 vjetësh dhe kryesisht i ka kënduar heronjve të kombit përfshirë këtu këngët lirike dhe epike. Ne kemi qenë me fat që kemi pas një poet të madh sikurse ishte Gjokë Beci i cili e kishte penën e artë dhe tekstet e tij kanë qenë frymëzim për ansamblin Mirdita.

Në Klinë kam qenë qysh në vitet e para kur organizohej ky festival dhe ndihem shumë i lumtur që serish jam këtu me Grupin e burrave-Mjeshtri i Madh.

E ndjej vetën si në shtëpinë time, sepse në Klinë kam njerëzit e mi, të familjes time, kam gjysmën e fisit tim që jetojnë në rrethin e Klinës prandaj në Klinë

nuk vij vetëm për të marrë pjesë vetëm në festival por edhe për të vizituar më të afërmit e fisit tim, thotë Kastriot Kola.

Ai tutje shprehet se në festivalin "I Këndojmë Lirisë" merr pjesë për herë të dytë dhe këtë radhë me grupin e burrave kënduan këngë për "Mujë Krasniqin" dhe disa këngë tjera me motive lirike dhe patriotike.

Ti këndohet Mujës dhe Beqës, ne i këndojmë lirisë së Kosovës, sepse ata dhanë më të shtrenjtën, jetën e tyre për liri.

Tutje Kola shprehet se ky ansambël ka marrë pjesë edhe në vise tjera shqiptare por edhe jashtë vendit, ku ka marrë çmime të ndryshme artistike. Ne kthehemi në Shqipëri më përshtypjet më të mira për mikpritjen që na bëjnë vëllezërit tanë, dhe organizatorët e këtij festivali", ka thënë Kastriot Kola.





KOZETA BRUCI

Intervistë me Kozeta Bruci, gazetare, nga Shkodra, ish moderatore e Festivalit "I Këndojmë Lirisë"

FESTIVALI "I KËNDOJMË LIRISË" ËSHTË NJË ORGANIZIM QË KA KRIJUAR AUTORITETIN E TIJ

Sadri HAXHAJ

REVISTA LYRA: Ju keni moderuar e drejtuar koncerte e festivale të ndryshme. Çfarë do të thotë për ju?

Kozeta Bruci: Prej 22 vitesh kam pasur fatin të moderojë me dhjetëra aktivitete artistike, kryesisht festivale të karakterit folklorik. Ndoshta për krijimin e këtij profili ndikoi puna ime si gazetare terreni në realizimin e reportazheve pothuajse në të gjithë territorin shqiptar, dhe jo vetëm. Kjo ndikoi ndjeshëm në njohjen e traditave dhe kulturës së çdo krahine, historisë dhe

mendësisë së banorëve. Por nuk munguan as rastet e moderimit të spektakleve kryesore të tilla si: Sofra Shkodrane, Dita e Diasporës, Dasma në Bejtet Shkodrane, Festa e Çobanit, Sofra e Kelmendit, etj.

REVISTA LYRA: Keni drejtuar festivale në Shqipëri e Kosovë, ka ndonjë dallim?

Kozeta Bruci: Më është dhënë mundësia që pos në Shqipëri të moderoj festivale edhe në Kosovë. Si në Kosovë ashtu dhe në Shqipëri, veshjet origjinale po shkojnë drejt varfërimit dhe artizanet, duke qenë se iu mungon dijetëria po bëjnë gabime të pafalshme në mënyrën se si i përgatisin kostumet kombëtare. Instrumentet muzikore të vjetra po zëvendësohen me elektronikën. Dhe ajo që është më kryesorja, mungojnë profesionistët në organizimin e festivaleve. Pasojat shihen sidomos të disiplina artistike, skenari, etj.

REVISTA LYRA: Sa është ndjenja e përgjegjësisë para spektatorit?

Kozeta Bruci: Spektatori është gjykuesi më i mirë i moderimit. Shpesh këtë të fundit e barazojnë me aftësinë oratorike, ose siç thuhet në mënyrë paradoksale "Flet rrjedhshëm, prandaj ky moderator/e është i/e mirë". Ky është një gabim që bëhet shpesh. Në mjaft raste libretet çalojnë dhe moderatores i duhet të plotësojë skenarin nga vetja e saj. Por çfarë plotëson?! Çdo moderator/e i duhet një përgatitje e mire paraprake, ku në varësi të vendit në të cilin mbahet koncerti, të lexojë për atë vend, të njohë traditat, etj. Moderatorja ka

në dorë gjithë çelësin e suksesit të një festivali, sidomos nëse ajo ka eksperiencë. Krijohen situata të papritura ku të duhet të improvizosh në çast dhe të kalosh me sukses një situatë të sikletshme. Moderatorja bën lidhjen "kimike" mes skenës dhe publikut, i bën të bashkëveprojnë mes tyre. E kjo natyrshëm sjell suksesin e aktivitetit.

REVISTA LYRA: Keni moderuar edhe Festivalin folklorik "I Këndojmë Lirisë" në Klinë. Çfarë ndjenje keni pasur kur keni dalë para publikut, kur dihet se në këtë festival i këndohet, lirisë, heronjve?

Kozeta Bruci: Për mua ka qenë moderimi më emocionues në jetën time që kam bërë në Festivalin "I Këndojmë Lirisë" para 10 vitesh, ndoshta. Për mua ishte hera e parë të drejtoja një festival të tillë kaq të rëndësishëm jo vetëm në Klinë, por edhe Kosovë. Nuk do ta harroj impaktin e parë kur pashë rreth skenës, të ngritur në shesh, rreth 5000 spektatorë. Ka qenë një përgjegjësi e jashtëzakonshme, pasi para meje e kishte drejtuar ikona e RTSH Silvana Braçe, prandaj duhej një përgatitje e mirë paraprake. E kujtoj që bashkëpunimi me stafin organizues të festivalit ka qenë i ngushtë, gjë që ma lehtësoi ndjeshëm punën. Po ashtu, festivalit i paraprinte ceremonia në shtëpinë e komandant Mujë Krasniqit, gjë që ndikoi në përgatitjen emocionale për mënyrën se si duhej t'i jepja tonin e duhur moderimit. Një pjesë e grupeve artistike i njihja në Shqipëri, në aktivitete tek ne, ku ata janë pjesëmarrës.

Baladë për Mujë Krasniqin

Mujë Krasniqit dhe 36 të rënëve
Në Gorozhub, më 14 dhjetor 1998

Kush është ai që zbret nga mali
Është Mujo Komandanti
Është ai, Muja vetë, me njëqind e dyzet
Nga po vjen, nga Tropoja a nga Vlora?
Kah vjen ai shkrinë bora
Vjen në borë vjen në shi
Nga Shqipëria në Shqipëri

As hëna nuk kishte dalë
Rrëze bjeshke atë natë
Vetëm terri shtrihej si gjarpër i zi
Terri që ndante atdheun në dysh
Atdheun e moçëm nën qiellin gri
Dhe pjesën tjetër nën shi... nën shi...

E rruga ishte e largët tek zhdukej në
pafundësi
Ai vështron fushat e paskaj të
Kosovës
E mendon për zogjtë:
Nuk ka vend më t'bukur fluturimi
Kur flet me lumenjtë thotë:
Është vend i papushtuar
Kur numëron plagët shton:
Vetëm vdekja ia shton bukurinë lirisë

Pastaj zbardh dita e plogësht
Dhe ëndërr e keqe numëron 36 herë
Dhembja shtron gjakun përdhe
Vashat shamizeza ulur nën një breg
Kanë ndalur pranverën e bimët që
mbijnë
Diku në një shteg... diku në një rimë

Ai sërish ngrihet dhe nis këngën e
moçme
Që këndohej në anët tona:
Nuk po mundem or shokë me fol
Se m'ka ra do gjak në gojë...

(Këtë tekst të kësaj balade të Tahir
Deskut, pas disa shkurtimeve e
shtimeve, e ka bërë tekst për këngë
Ilir Shaqiri)

Shaqir Foniqi

Muja

Ti kishe zbritur nga legjendat
E Halilit

O trim, e shkuar trimit
Luftove dhëmb me dhëmb

Armikut i dole
Kapuç me mëngë
Mujë, o Mujë

Emri yt

Nuk do të harrohet kurrë
Derisa bukës t'i thuhet bukë
E ujit, ujë

Ti Mujë trimi

Nuk pranove asnjë lloj
nënshtrimi!

'Qenqe nuk jetohet, armiku
në... të samës'!

E mbylle jetën në fushëbetejën
e nderit

Armikut ja fute tmerrin

Ti Mujë e 'preke qiellin'

E kapërceve Ylberin

U bëre Ylber


Që nuk shuhet asnjëherë

Dhe shfaqësh ylberisht

E shqiptarisht

Në çdo Pranverë!

Vjershë kushtuar Mujë Krasniqit-
Kapuçit



Intervistë ekskluzive me Ilir Shaqirin, artistin e këngës

KËNGËTAR I LUFTËS DHE I LIRISË

Enver MALOKU

REVISTA LYRA: Njiheni si këngëtar i lirisë. Keni kënduar dhe vazhdoni t'i këndonit lirisë dhe trimave të saj, duke mos u lodhur. A do të thotë kjo se ju përfillni thënien se për atdheun nuk duhet me u lodhur kurrë duke punuar dhe duke dëshmuar?

LIRI: Patjetër, atdheu është dashuri e madhe: është nëna që të ka lindur, është djepi që të ka rritur, është babai që të ka udhëzuar, është mësuesi që të ka mësuar, atdheu është luftëtar që të solli lirinë, është poeti që shkruan pavdekësinë. Atdheu është ajri që të mban gjallë dhe ata që luftojnë e punojnë për të, të pa vdekur i shpallë.

REVISTA LYRA: Këngët tuaja ishin frymëzim dhe motivim në çdo betejë luftës së lavdishme të UÇK-së. Si ndjehet artisti kur këngët bëhen lajtmotiv i lirisë?

LIRI: Artet në përgjithësi e muzika në veçanti, janë pararendës të artikulemeve më përmbajtësore të ndjenjave dhe dëshirave të një populli, që lirinë e do më shumë se jetën. Të jesh zëri i atij brezi që

formësoi lirinë dhe pavarësinë e atdheut është ndjenjë krenarie, vështirë e shpjegueshme.

REVISTA LYRA: Ishit pjesë e Trupës Artistike "Hamzë Jashari" në flakët e luftës, si jeni ndier?

LIRI: Pas betejës së lavdishme të Prekazit, bashkë me një grup artistësh u nisëm në një turne të gjatë nëpër Evropë, në përkrahje të luftës për liri. "Homazh për Kosovën" ishte thirrje artistike që t'i dalim zot atdheut. Gati në të gjitha kryeqytetet e Evropës dhe qytete tjera, aty ku jetonin dhe punonin shqiptarët, ne dhamë 109 shfaqje. Mbaj mend se nga këto koncerte, pa u kthyer në vendin ku banonin, shumë djem dhe vajza niseshin për tu bërë ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ata kërkonin nga ne artistët një adresë, në Shqipëri, që të merrnin armët dhe të hynin në frontet e Kosovës. Në muajin shkurt të vitit 1999, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare kishte vendosur të themelonte Trupën Artistike Ushtarake "Hamzë Jashari". Isha tepër i nderuar që po bëhesha njëri nga anëtarët, përkrah luftëtareve, nën betimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

REVISTA LYRA: Keni kënduar edhe në luftë, përveç me zërin tuaj në vatrat e luftës keni qenë edhe fizikisht, keni kurajuar luftëtarët, i keni kënduar lirisë me sloganin "Me art kundër dhunës". Sigurisht keni pasur sfida e sprova të mëdha për atdhedashuri. Si i keni përballuar?

LIRI: Heroizmi i Komandantit Legjendar Adem Jashari, akti sublim i tij, vrau frikën ndër shqiptarë. Gjithkush donte të bënte diçka, shumëkush gjente formë për të bërë diçka, pa marr parasysh rreziqet. Nuk kishte sfida të pakapërcyeshme për të qenë pjesë e një brezi që do çlironte vendin me patjetër.

REVISTA LYRA: Një nga këngët lapidare është balada kushtuar Mujë Krasniqit-Kapuçit, me tekst të reporterit të luftës, Tahir Deskut. Këtë këngë e keni kënduar edhe në Festivalin Folklorik "I këndojmë Lirisë", në Klinë, në hapje të tij. Si ndihet artisti kur i këndon lirisë, heronjve të saj, siç ishte Komandant Muja?

LIRI: Liria erdhi dhe bashkë me të një shkëlqim i bukur i jetës sonë. Shkëlqim që nuk do ta lëmë kurrë të venitet, asnjëherë, duke kujtuar ata që jetët e tyre i flijuan për dritën e syve tanë dhe brezave që do vijnë. "I këndojmë lirisë" ishte sloganin më i bukur për të kujtuar themeltarët e lirisë sonë. Dhe jam tepër i nderuar që ky festival hodhi hapin e parë me zërin tim, me fjalët më poetike të mundshme të Tahir Deskut, për gjigantin e UÇK – së, Mujë Krasniqi.

REVISTA LYRA: Keni kënduar në luftë para ushtarëve të UÇK-së, por edhe në liri para spektatorëve të shumtë. Si është ndier Ilir Shaqiri në këto evenimente krejtësisht të kundërta, të këndosh në zjarrin e luftës e të plumbave, dhe liri të shumë shtrenjtë me gjakun e bijve e bijave më të mira të kombit?

LIRI: Sa më shumë që ikën koha, njeriu bëhet më i ndjeshëm, duke sjellë në mendje posaçërisht kohën e një epoke vështirë të kapërcyeshme. Këngët e atdheut, ato që i dedikohen dëshmorëve të lirisë, heronjve të Kosovës, gjithmonë më kthejnë kujtesën aty dhe atje ku gatuhej më shumë barut sesa bukë. Kjo kujtesë duhet akoma të formësohet përmes arteve të bukura, duke u lënë brezave një trashëgimi, pasqyrë të kthjellët si: në poezi, në prozë, në pikturë, në skulpturë, në teatër, në këngë e në film. Gjithçka tjetër humbet, përveç historisë dhe arteve që frymëzohen prej saj!



Gjon Frroku, rapsod i njohur nga Lezha

"MJESHTRI I MADH" NGA LEZHA PËR FESTIVALIN FOLKLORIK "I KËNDOJMË LIRISË"

Enver MALOKU

Gjon Frroku është emër i njohur i folklorit shqiptar, rapsod i përmasave kombëtare. Për meritat në fushën e këngës folklorike ai edhe ka marrë titullin "Mjeshtër i madh". Frroku, menjëherë pas luftës kishte ardhur në Kosovë, përkatësisht në Klinë duke kontribuar në ringjalljen e jetës kulturore, veçanërisht të asaj muzikore. Ai flet me admirim për Klinën dhe kohën sa kishte qëndruar në Klinë, duke veçuar mikpritjen vëllazërore që i ishte bërë. Për të gjitha këto biseduam me "Mjeshterin e madh, Gjon Frrokun, i cili që në fillim shprehet për qëndresën shekullore, sakrificën dhe fushëbetejat e Kosovës për çlirimin e saj. "Lufta ka një emër dhe emri i saj është gjaku i bijave dhe bijve, që u flijuan për liri. Klina me rrethina, zë një vend historik, në këtë qëndresë heroike. Mund të përmendim heronjtë e Kombit, Mujë Krasniqin, e shumë e shumë të tjerë", nis bisedën që zhvilloam për gazetën "Lyra".

INTERVISTË

Revista LYRA: Kur erdhët për herë të parë në Klinë dhe si e gjetet atë?

Gjon Frroku: Me 1 maj të vitit 2000 u zhvendosa në Klinë dhe bukën e parë e kam ngrënë në familjen e Martin Rexhës. Administrata e Komunës me kryetar, Ramadan Krasniqi, më autorizuan angazhimin tim në "Jehonën e Dukagjinit", Klinë. Arsyeja e ardhjes time qëndronte te vullneti e dëshira, që të jem një ushtar për rimëkëmbjen dhe ringjalljen e kulturës së pasluftës. Klinën e gjeta të plagosur, të shkatërruar, por kurrë të nënshtruar, kurrë kokulur, por krenare, ballëlart për qëndresën heroike dhe optimiste për të ardhmen e saj. Populli i Klinës për mua është një familje e dytë e imja. Nga momenti i prezantimit tim në Klinë, dua të falënderoj me gjithë zemër.

Revista LYRA: Cili ishte angazhimi i juaj në Klinë?

Gjon Frroku: Kontaktin e parë e mora me drejtuesit e kulturës të posa dalë nga lufta për të punuar me "Jehonën e Dukagjinit". Premiera e parë folklorike që unë e kisha titulluar, ishte "Nën qiellin e kaltër". Për ta realizuar këtë i pari veprim ishte takimi me artistë të rinjë e të vjetër të "Jehonës së Dukagjinit" dhe vendosëm të bënim një konkurs shumë dashamirës dhe të mirëkuptuar, për të parë talentet që kishim në dispozicion deri në ato momente. Mbas përzgjedhjes nisëm punën dhe përgatitem grupin "Jehona e Dukagjinit" me një program me valle, këngë patriotike për heronjtë dhe heroinat e lirisë, melodi të ndryshme, etj. Këngët

kushtoheshin Legjendarit Adem Jashari, Heroit Mujë Krasniqi (Komandant Kapuçi), etj, etj. Këtë premierë e kemi shfaqur tri herë në Radio-Televizorin e Kosovës, tri ditë në Lezhën e besëlidhjes së Gjergj Kastriot (Skënderbeut) e binjakëzuar me Klinën, ku unë kam fatin të jem kumbara i lidhjes shpirtërore.

Në Komunën e Klinës, që nga organizimi i parë i Festivali Folklorik mbarëkombëtar i Këndojmë Lirisë", kushtuar heroit të kombit Mujë Krasniqi- Komandant Kapuçi isha, prezent me grupin folklorik nga Lezha, pos, kur isha anëtar jurie. Në këtë festival i është bërë nderë jo vetëm Klinës por mbarë kombit e në veçanti të gjithë atyre që falën gjakun për lirinë e Kosovës.

Respekti i popullit të Klinës dhe autoriteteve vijon me këto mirënjohje:

1. Mirënjohje publike

2. Qytetar Nderi i Komunës Klinë,

Janë me dhjetëra mirënjohje dhe vlerësime për kontributin tim në art dhe kulturë. Vlerësimi më i lartë për mua është dera e hapur në çdo familje të Klinës, dera e hapur në të gjitha institucionet e kësaj Komune e qershia mbi tortë janë duartrokitjet e ngrohta të popullit të Klinës sa herë kam dalë unë para tyre. Mirënjohje të thellë për të gjithë familjet e dëshmorëve, për veteranët e luftës çlirimtare të Kosovës, në veçanti të Klinës si dhe për çdo qytetar të kësaj Komune e më gjerë. Respekt për artistët, këngëtarët, poetët, shkrimtarët e Komunës, për të gjithë emër për emër, që kanë dhënë kontribut ku me ta ruaj kujtime të përjetshme... Shpreh gatishmërinë time duke qenë kontribuues për kulturën dhe artin në Kosovë e në Klinë në veçanti deri në frymën e fundit..

Komandant Mujë Krasniqi-Kapuçi "ATDHEU ËSHTË MË I SHTRENJTË SE JETËT TONA!" "KTHIM PRAPA NUK KA!"

Shkruan Asllan BAJRAMI

Ishte data 14 dhjetor, viti 1998.



Në redaksinë e lajmeve të Kosovës pranë Radiotelevizionit Shqiptar zotëronte një heshtje varri. Nuk ishte një ditë e zakonshme. Qarkullonin lajme nga më të ndryshme nga zonat e përfshira në luftë. Lajmet që ne siguronim qoftë nga burimet tona, e veçanërisht lajmet me burime të jashtme, ishin më se kontradiktore. Një telefonatë që kishim regjistruar në Redaksinë tonë, por që nuk ishte transmetuar, gazetari ynë i Radio Tiranës, na njoftonte nga Kukësi, se në drejtim të kufirit në zonën e Hasit, hamendësohej për dhjetëra të vrarë, përtej vijës kufitare. Sipas gazetarit tonë, i cili i referohej burimeve ushtarake të Postës Kufitare Shqiptare, dyshohej se në orët e para të datës 14 dhjetor 1998 në territorin e Kosovës janë dëgjuar të shtëna armësh, njëherësh. Ky ishte një dyshim i bazuar për një sulm befasues të forcave armike serbe mbi një karvan të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët para se të kalonin kufirin, janë vënë re të jenë grumbulluar në orët e vona të datës 13 dhjetor 1998, në afërsi të kufirit, tek Likenet e Hasit. Sipas dëshmitarëve, të cilët ishin kontaktuar nga disa reporterë në qytetin e Krumës, por edhe nga kontaktet me pjesëtarë të UÇK-së, që lëviznin dhe patrullonin përgjatë brezit kufitar, karvani i luftëtarëve që synonte të futej në Kosovë, numëronte më shumë se 100 pjesëtarë të UÇK-së. Më vonë mësuam se bëhej fjalë për 143 luftëtarë, të cilët do të futeshin në territorin e Kosovës me armatime dhe municione.

Ne bënim përpjekje për të siguruar sa më shumë hollësi për gjithçka që ndodhte në afërsi të kufirit. Ndërkohë, morëm vesh se ky karvan i luftëtarëve të lirisë udhëhiqej nga komandant Mujë Krasniqi i njohur me nofkën "Kapuçi". Në momentin që është lakuar emri i Mujë Krasniqit, ne e dinim mirë se për kë bëhej fjalë.

Emrin e Mujë Krasniqit, e kishim mësuar që kur

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte shfaqur publikisht më 28 nëntor 1997, kur ai bashkë me Rexhep Selimin dhe Daut Haradinajn shpërfaqen Platformën Politike të UÇK-së në Llaushë të Skënderajt në ceremoninë e varrimit të mësuesit Halil Geci, i vrarë nga policia serbe. Qysh në dhjetor të vitit 1997, në prag të festave të fund vitit, në programet e Radio Tiranës kishim transmetuar një radioreportazh të zgjeruar për daljen publike të UÇK-së, si ngjarja më e rëndësishme e vitit, e cila do të bënte kthesën historike për fatet e Kosovës dhe të ardhmen e saj.

Radioreportazhin tonë dhe një kronikë përmbledhëse televizive, i kishim ndërtuar me mjaft kujdes duke përfshirë edhe dy telefonata nga terreni, njëra e gazetarit dhe reporterit të luftës nga Zona Operative e Drenicës Tahir Desku dhe tjetra e reporterit të luftës nga Zona Operative e Dukagjinit Fetnete Ramosaj.

Gazetari Desku tregonte se Mujë Krasniqi ishte njëri ndër luftëtarët e orëve të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, organizator dhe pjesëmarrës i aksioneve të fshehta kundër forcave të pushtuesit serb, por mbi të gjitha, ai ishte i pandarë me kryeluftëtarin dhe kryekomandantin Adem Jashari qysh në krye të herës, atëherë kur ishin krijuar bërthamat e para çlirimtare. Po në këtë radioreportazh reporterja Fetnete Ramosaj, do ta portretizonte Mujë Krasniqin si një luftëtar të pashoq dhe si një ndërlidhës ose koordinatues të veprimeve luftarake midis tri Zonave Operative të UÇK-së, - Drenicë, Dukagjin dhe Pashtrik.

Nga lajmet që ne kishim siguruar në datën 14 dhjetor 1998, ishte vështirë të besojë se një grup prej 40 e ndoshta edhe më shumë luftëtarësh të lirisë të kenë rënë në pritë të forcave armike serbe. Askush prej nesh nuk donte t'i besonte këtij lajmi. Ne hezitnim që këtë lajm ta transmetonim pa një konfirmim të besueshëm, edhe pse unë si përgjegjës i redaksisë që isha, e kisha të qartë dhe të konfirmuar vërtetësinë e lajmit tragjik për vrasjen e komandant Mujë Krasniqit. Ai kishte rënë pas një lufte fyta-fyt me forcat armike serbe, në vendin e quajtur Gorozhup, aty ku forcat armike serbe kishin zënë pritë.

Nga raportimet e tyre, morëm vesh se në këtë përballje befasuese me forcat armike serbe bashkë me komandant Mujë Krasniqin, kishin rënë edhe të paktën 31 luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Reporterët tanë duke u bazuar në disa dëshmi nga vendi i ngjarjes tregonin se e gjithë zona e Pashtrikut ishte përfshirë nga një mot i keq, ku trashësia e borës thuhet se ishte e papërballueshme. Nga ato pak dëshmi që ne kishim siguruar, mësuam se disa nga luftëtarët e UÇK-së ishin zënë rob, disa të tjerë të plagosur janë parë të kenë ngrirë në borë, si pasojë e temperaturave të ulta, ndërsa një numër tjetër kishte arritur të futej më thellë në territorin e Kosovës.

Radio kronika e zgjeruar mbi ceremoninë e varrimit të Komandant Mujë Krasniqit-Kapuçi dhe të bashkëlufetarëve të tij më 21 dhjetor 1998 në fshatin Polac të Drenicës, ishte një material radiofonik tepër

domethënës.

Komandant Kapuçit, si një luftëtar i pashoq, i pathyeshëm, guximtar, i vendosur dhe patrembur përballë çdo situatë, edhe kur ai ishte i plagosur, jo njëherë por disa herë. Reporteri i luftës dhe luftëtari Tahir Desku, gjatë transmetimit të telefonatës së tij mezi përmbahej, veçanërisht ku tregonte se Muja 31-vjeçar i pamartuar, do të mbahet mend për jetë e mot si një luftëtar i paepur i orëve të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke bërë krenar çdo shqiptar kudo që është, në istikamet e luftës, në çdo cep të atdheut, në Mërgatë, fëmijët, gratë, burrat por edhe ata që do të lindin dhe që do të gëzojnë lirinë për të cilën Mujë Krasniqi dhe secili luftëtarë i UÇK-së lufton dhe nuk do të ndalet deri në çlirimin e tokës së shenjtë, të Kosovës dardane. Gazetari Desku, kur nis dhe përmend emrat e familjarëve të Mujë Krasniqit, zëri tij merr një drithërimë të shoqëruar edhe me lot duke ngushëlluar por edhe duke ju dhënë forcë babës Halil e nënës Sherife, vëllezërve Ajeti, Mustafa, Avniu, Afrimi dhe Kujtimi si dhe motrave Sala, Ganimetja, Mihanja, Shehrija dhe Selvetja.

Gjatë transmetieve ditore të Radio Tiranës, redaksia jonë atë botë ka përgatitur një material të zgjeruar mbi jetën dhe veprimtarinë patriotike e luftarake të Mujë Krasniqit, të titulluar "Kthim prapa nuk ka". Ky nuk ishte thjeshtë një urdhër i komandant Mujë Krasniqit por ishte edhe motoja e tij si luftëtar dhe si Komandant i Brigadës 113 të Zonës Operative të Drenicës. Ai vazhdimisht i kujtonte bashkëluftëtarët e tij se "Atdheu është më i shtrenjtë se jetët tona". Materiali ynë radiofonik tregonte edhe për jetën e vështirë të Mujë Krasniqit, si të çdo shqiptari në tokën e robëruar e të pushtuar nga Serbia. Papajtueshmëria e Mujë Krasniqit me pushtuesin serb vërehej që në vitet e djalërisë së ti. Ai brumosej me atdhedashuri, i nxitur dhe motivuar edhe nga tregimet nëpër kullat dhe odat e Drenicës, Dukagjinit dhe kudo që shkonte, në çdo trevë të Kosovës. Mujë Krasniqi e kishte kuptuar se "forcën që të jep atdheu, nuk e gjen askund tjetër".

Ne materialin tonë radiofonik kemi spikatur ato motive që ishin nxitëse, frymëzuese e mobilizuese për Mujë Krasniqin, siç ishin demonstratat dhe protestat e pareshtura të shqiptarëve të Kosovës në vitet '80-të e '90-të kur Mujë Krasniqi nga fshati i tij i lindjes Çabiqi, shkon e bëhet pjesë e pandashme e bërthamave të para çlirimtare të UÇK-së përkrah kryekomandantit legjendar Adem Jashari dhe heronjve e trimave të tjerë të Kosovës. Në këtë material të zgjeruar radiofonik kushtuar Komandant Mujë Krasniqit janë përfshirë edhe aksionet luftarake që Muja organizonte dhe ndërmernte së bashku me Sylejman Selimin, Abedin Rexhën, Rexhep Selimin, Adrian Krasniqin, Luan Haradinajn, Zahir Pajazitin e të tjerë, duke goditur dhe sulmuar postat policore dhe postbllloqet e policisë

okupatore serbe. Ky material radiofonik ngërthen në vete edhe shumë detaje të tjera që lidhen me veprimet luftarake të Mujë Krasniqit, duke spikatur aksionet e Njësitit luftarak "Alfa", i formuar me nismë të Komandant Kapuçit. Në formacionin e këtij njësi ishin së bashku me Mujë Krasniqin, Bekim Berisha, Rasim Kiçina, Ferid Berisha, Bekim

Mala-Murrizi, Bekim Shyti e të tjerë luftëtarë të lirisë. Materiali ynë radiofonik shoqërohej nga disa pasazhe këngësh folklorike që Muja i këndonte së bashku me të mirënjohurin Beqir Gashi-Mleqani, gjithashtu dëshmor i atdheut. Ata këndonin gjatë orëve të pushimit midis operacioneve luftarake së bashku edhe me Rexhep Selimin dhe të tjerë luftëtarë. Këngët që këndoheshin, u jepnin forcë dhe një motiv shtesë luftëtarëve të lirisë. Ndërsa, bisedat që shkëmbente Mujë Krasniqi me bashkëluftëtarët e tij i dedikoheshin atdheut, figurave të njohura të historisë sonë kombëtare, luftërave të parreshtura të popullit tonë për çlirim dhe bashkim kombëtar. Materialin radiofonik kushtuar Komandant Mujë Krasniqit-Kapuçi e kemi përmbyllur me disa thënie për atdheun të deklamuar me mjaftë mjeshtri dhe shije artistike nga artisti Mirush Kabashi, duke spikatur në plan të parë fjalët e At Gjergj Fishtës, të cilat Muja shpesh herë i recitonte para bashkëluftëtarëve të tij, "Deri sa t'mundem me ligjrue, e sa gjallë me frymë unë jam, kurrë Shqypni s'kam me t'harrue, edhe n'vorr me t'përmend kam".

Duke e kujtuar Mujë Krasniqin, këtë personalitet të shquar, veprimtar, atdhetar, luftëtar dhe komandant lufte, ne kuptojmë gjithë dimensionin, peshën, vlerën dhe rëndësinë historike të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që solli çlirimin, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Edhe festivali "I këndojmë lirisë" në 24-vjetorin e ekzistencës së tij që mbahet në ditëlindjen e të pavdekshmit Mujë Krasniqi, ka dhe duhet të ketë në vazhdimësi mbajtjen gjallë të shpirtit luftarak dhe liridashës të popullit tonë. Krijuesit e këngës, kompozitorë dhe autorë tekstesh, gjithmonë dhe kurdoherë do të gjejnë motive të lufta jonë e drejtë, e ligjshme dhe e natyrshme. Ky festival meriton mbështetje të vazhdueshme që të jetë edhe më madhështor siç ka qenë madhështore dhe ngadhënjimtare lufta e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës.

FESTIVALI FOLKLORIK “I KËNDOJMË LIRISË”, SIVJET PA NËNËN SHEHIDE

Enver MALOKU



Në Festivalin Folklorik gjithëkombëtar “I Këndojmë Lirisë”, sivjet na mungon një nënë e madhe, ajo është Nënë Shehidja, nëna e dy heronjve të kombit, Mujë e Ali Krasniqit. Ajo këtë vit nuk është në mesin tonë fizikisht, një grua e cila përkundër sakrificave e dhimbjeve të mëdha qëndroi gjithmonë si një heroinë e vërtetë. Ajo sot nuk është fizikisht në mesin tonë, por ne do ta kujtojmë gjithmonë si grua e fortë, atdhetare, nënë heroinë e simbol i gruas shqiptare. Kalojnë vite, kalojnë edhe shekuj e kujtimi për dëshmorët mbetet i freskët prore në mendjet tona. Dëshmorët janë të pavdekshëm, janë ndërgjegjja e kombit. Ata jetuan për ne. Lapidarë të lirisë ishin vetë ata, që u bënë flakadanë të përjetësuar. Nëna Shehida, ishte simbol i gruas së fortë shqiptare, simbol nderi krenarie. Në një shënim të më hershëm, sa ishte gjallë nëna Shehida, në gazetën Lyra ishin shkruar edhe këta rreshta për nën e Mujës e të Aliut: “Forca karakteri i saj i madh bëri që të rritë trima heronjtë dalëzotes të atdheut, dhe djemtë kreshnikë që me pushkët e tyre çlirimtare dhe gjakun e derdhur luftuan për çlirim dhe bashkim kombëtar. Ajo kurrë nuk u thye, nuk u ligështua edhe kur humbi djemtë e saj për atdhe. Nuk u panë lotë në sytë e saj, por veç krenari dhe mburrje sepse të tillë i kishte rritur djemtë të jenë në shërbim të atdheut. Sa bukë kanë ngrenë nga nënëlokja e UÇK-së, me mijëra ushtarë në kullën e qëndresës dhe mikpritjes shqiptare në fshatin Çabiq”. Ajo si një burrëreshë, si një heroinë, shpesh thoshte se në Festivalin Folklorik “I këndojmë Lirisë”, ku ju këndohet bijve të saj dhe dëshmorëve të tjerë të renë për liri, është dhimbje por

njëkohësisht edhe e krenari, për te ushtarët e UÇK-së ishin dasmorë të lirisë. Janë të shumta sakrificat e mundin që kishte bërë ajo për ushtarët e lirisë. Dhe gjithnjë thoshte pak është kjo që ka bërë. Bënte ushqime dhe të kujdesej për ata, por dashuria e madhe për lirin e vendit e bënë të pathyeshme nënë Shehidën. Për gazetën Lyra kishte folur me nostalgji për kohën e luftës. Kujtonte bashkëluftëtarët e bijve të saj, kishte dëshirë ti shoh ata dhe ti takonte, sepse kështu i dukej se po i sheh bijtë e saj. “Është krenari se kanë shku bijtë e mi për liri, dhimbja është po edhe krenaria. Kam dëshirë me ardh shokët e bijve të mi ajo më mban gjallë, po nuk po vijnë, dukët se na kanë harru”, kishte thënë nënë Shehidja. Ajo kishte gatuar bukë për ushtarët e UÇK-së, në çdo kohë, natën ditën. Ishin kohë të rënda, por ajo kishte besim te Muja, Beqa, Ali e ushtarët tjerë. Shehidja ishte e pranishme në çdo festival, ndjehej e mallëngjyer kur dëgjonte këngët që u kushtoheshin, Mujës, Beqes, Aliut e luftëtarëve të tjerë. Sa i madh është malli për ta, sa dhimbje, sa krenari. Festivali dhe respekti ia lehtësonin. Sot Festivali “I Këndojmë Lirisë”, për do vit përkujton Mujën, Aliun, Beqën dhe gjithë ata që ranë në altarin e lirisë. Kënga dhe vallja jehon për ta në Sheshin “Mujë Krasniqi”.

Kështu ishte edhe sivjet, kështu do të jetë edhe viteve që do të vijnë.



LUFTA, KËNGA, INFORMIMI DHE LIRIA E KOSOVËS

Shkruan Enver MALKOKU



Pas një rruge të gjatë e përpjekjesh të pa reshtura dhe shekuj qëndrese për liri, me gjak e plagë me sakrifica sublime, Kosova është shtet i pavarur e Sovran, i njohur dhe ndërkombëtarisht nga shtetet më të fuqishme në botë. Merita më e madhe për këtë i takon Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pjesëtarëve të saj gjakut të derdhur të bijve e bijave më të mira të Kosovës. Rrjedhimisht kjo ushtri është ushtria më e

lavdishme e popullit shqiptar e cila ndryshojë rrjedhën e historisë. Lufta e saj jo vetëm që ishte e armatosur por edhe shumë dimensionale. Në tri fronte duhej fitore, në frontin e luftës, të diplomacisë dhe të informimit dhe që në të trijat doli fitimtare. Ushtria Çlirimtare e Kosovës këtë fitore nuk e kishte arritur lehtë, por me një forcë dhe qëndresë të pathyeshme, prandaj edhe është themeli i Pavarësisë së Kosovës. Ajo bëri që Kosova të mos zmbropset, shqiptarët qëndruan, nuk u tjetërsuan, nuk u asimiluan, prandaj edhe fituam. Lufta kishte karakter çlirimtar nacional për shtet, ndërsa propaganda serbe në rolin e dhelprës që nuk pretendon asnjëherë të vërtetën, por në vend të saj gënjeshtër, është përpjekur të gjejë gënjeshtër dhe janë vënë që t'i gjejnë 10 të tilla në ditë, dhe nga refreni marramendës i tyre fillojnë t'u besojnë edhe vetë. Kjo është pjesë e gjenit kulturor të tyre, krenaria kombëtare serbe. Shqiptarët nuk identifikuan asnjëherë aspiratën e tyre nacionale me përkatësi religjioze. Substrati fetar ishte, siç është sot e përherë, krejt natyrshëm në privatësinë individuale të njeriut shqiptarë.

Na kujtohet fare mirë kur bërthama e saj e parë u prezantua në mjetet e informimit për lindjen e një ushtrie të mirëfilltë të popullit, për t'i dalë zot atdheut. Aty këtu kishte hamendje e dilema për fillimet e saj, se liria vjen vetëm me aktivitete e rezistencë politike, madje quhej edhe e kontestueshme e ultësisht edhe ushtri faksesh, që negatorët asokohe nuk u besonin apo nuk e kishin guximin ta bënin këtë, ndonëse edhe në atë fillim kishte vepra ushtarake, fillimisht guerile. Kësë cilësimesh gjendeshin në faqet e gazetave, mjerisht edhe shqipe. Mirëpo, më pas aksionet rezultuan tepër të qarta, reale dhe me fillësë përmbystare për okupatorin serb. Shtypi shqiptar ishte tkurrur tej mase,

por megjithatë u gjetën forma për të paraqitur forcën dhe gatishmërinë e UÇK-së për fitoren definitive. Alternativë tjetër nuk kishte. E drejta dhe liria nuk jepen, por fitohen, dhe nuk fitohen kurrë njëherë e përgjithmonë. Ndërsa, lufta e fundit e UÇK-së e dha provën dhe dëshminë finale se Kosova ishte e vendosur për pavarësi. Në njërën anë zhvillohej lufta, e në anën tjetër kishte zëra që për ta ruajtur substancën biologjike të kombit gjenin alternativa të tjera, dyshohej edhe në autorësinë aksioneve që po ndërmernte UÇK-ja. Edhe paraqitja publike e UÇK-së në varrimin e mësuesit Halil Geci në Llaushë para mijëra qytetarëve kishte lënë dilema, ndonëse atë natë në TVSH, programi për Kosovën, e dha qartë se UÇK-ja është forcë reale ushtarake. Njëri prej të treve ishte edhe vetë Komandanti Mujë Krasniqi-Kapuqi. Dhe prapë sprova. Ndërkohë, që në kullën e Jasharëve 10 vjet më parë (mars 1998) u zhvillua Epopeja e rezistencës heroike dhe gjysma e Kosovës ishte larë me gjak, në ndonjë qoshe të shtypit kërkoheshin të mbaheshin zgjedhjet. Në këtë kohë të lirisë apo të vdekjes kishte edhe huti. Apelet politike, konferencat për shtyp nuk po e sillnin pavarësinë në pako. Ushtarët e UÇK-së ishin në istikame nga zëdhënësi i UÇK-së njoftohej për përshkallëzim të situatës në terren për luftime, ndërsa reporterë e luftës nga afër raportonin për luftime të përgjakshme dhe për aksionet e suksesshme të UÇK-së. "Toka kurrë nuk do të bëhet parajsë e njerëzimi kurrë nuk do të bashkohet me Zotin..., por kur e di se cilës anë i përket jeton më i lirë", thoshte Herman Hess. "Kosova ishte një 'terra inkognita', një botë e largët që nuk dërgonte asnjë mesazh, që nuk kishte asnjë domethënie. Harresa, shlyerja e kujtesë historike doemos ishte krimi më i madh që në këtë kohë iu bë Kosovës. UÇK-ja u legjitimua, asnjë konferencë paqeje apo biseda diplomatike nuk mund të bëheshin pa faktorin e saj. Në konferencën e Rambujesë delegacionin e Kosovës e kryesonte përfaqësuesi i UÇK-së. "Pa Ramë Bujën, nuk ka Rambuje", (pjesë e delegacionit ishte edhe Ramë Buja). UÇK do të legjitimohej ndërkombëtarisht nga bota e lirë, si palë ndërluftuese, provat ishin dhënë. Qytetërimi shqiptarë me gjithë sprovat që iu desh të përballonte nëpër vite stuhish mbeti në rrënjën e tij të natyrshme-perëndimor, sepse është në zemër të Evropës. Diplomatat perëndimor bisedonin në Junik, Dragobil, Likoc e gjetiu me përfaqësuesit e UÇK-së (Holbruk, Hill, Petriq e të tjerë)

Në Kosovë ka ekzistuar vetëm një ushtri, e ajo ishte UÇK. Të tjerat nuk kanë ekzistuar. Vetëm UÇK-ja ishte vdekjeprurëse për Serbinë dhe kishte thyer heshtjen dhe status quon në Kosovë. Edhe këtu UÇK-ja ka dalë fitimtare.

KOMANDANT MUJË KRASNIQI DHE VETURA E TIJ E LUFTËS

Sadri HAXHAJ

Përveç epitetit hero i Kosovës për lirië që po e gëzojmë sot një nga trashëgimitë që na la pas Mujë Krasniqi është edhe vetura e tipi “Opel record, të cilën komandanti Mujë Krasniqi-Kapuçi e kishte përdorur në aksionet kundër policisë dhe ushtrisë serbe, si dhe për bartjen e të plagosurve të ushtarëve të UÇK-së. Me të kishte marrë pjesë në shumë beteja, në Dollc, Llapushnik, Gllavrevë etj. Pranë kullës muze në Çabiq, sot qëndron kjo veturë, dëshmi e kohës dhe e trashëgimisë. Ajo sot i shërben historisë së luftës dhe sot po qëndron si roje e lirisë së Kosovës në oborrin e kullës-muze të komandant Mujës. Edhe kjo veturë ka një histori. Ketë veturë ia kishte dhuruar Mujës një bashkëluftëtar. Mujës nuk i kishte rënë gjatë ta vozis këtë veturë, pasi që ai ishte plagosur tri herë. E kishte vozitur i vëllai i Mujës, Avniu si dhe beqir Gashi. Tash nga kjo distancë kohore, Avniu, i vëllai i Mujës tregon shumëçka për këtë veturë të luftës. “Muja e kishte përdorur këtë veturë për nevojat e luftës, për aksione dhe sidomos për bartjen e të plagosurve nëpër beteja. Vet baci Mujë ishte plagosur në luftë dhe më është dashur disa herë ta transportoj në Likoc për shërim. Kjo veturë është vozitur edhe nga ushtarë të tjerë apo ndonjë shofer personal, sepse Muja ishte i plagosur dhe nuk mundte ta drejtonte veturën. Sot kam në mendje ato ditë kur e kam shoqëruar bacin Mujë me këtë veturë, shumë herë me shpejtësi të madhe për të sjellë përfundime në frontet e luftës”, tregon Avni Krasniqi, vëlla i Komandant Mujë Krasniqit. Ai tregon për këtë veturë, pse ishte marrë pikërisht, kjo veturë, si është gjetur pas luftës. Vetura Opel ishte e përshtatshme për përdorim për shkak të shpejtësisë së madhe që kishte, për të mos rënë në pritë nga forcat serbe. Avniu, tregon se vetura ishte marrë nga forcat serbe, të cilët edhe e kishin përdorur për nevoja të tyre derisa kishte përfunduar lufta. “E kam gjetur pas përfundimit të luftës në fshatin Dollc të Klinës, në saje të një shokut që më kishte treguar dhe e kam identifikuar në saje të një shenje që kishte që nga koha e luftës. E kam sjellë te kulla që të jetë muze e kujtim i luftës për liri dhe histori. Nuk e kemi vozitur pas luftës, pos që e kemi ndezur herë pas herë për të qenë në gjendje të rregullt. E kemi mbuluar, që të ruhet sa më mirë”, thotë Avniu.



FOLKLORI ËSHTË THESAR I TRASHËGIMISË POPULLORE

Sadri HAXHAJ



Folklori është thesar i trashëgimisë popullore, është kulturë shpirtërore e një populli, pa folklor nuk mund të ketë kulturë kombëtare.

Këngët tona të bukura rapsodike të kënduara në frymën e eposit legjendar e historik të shqiptarëve, janë pasqyrë e jetës shqiptare dhe e mendësisë shqiptare, një mozaik poetik ngjarjesh historike e legjendare, personazhesh historike dhe jo historike, traditash e zakonesh të popullit shqiptar.

Një cikël i veçantë i këngëve rapsodike janë edhe këngët shqiptare të Eposit të Kreshnikëve janë cikël këngësh epike heroike legjendare. Ato radhiten ndër shtyllat më të rëndësishme artistike të kulturës shpirtërore të shqiptarëve. Eposi i Kreshnikëve është jehonë poetike disa shtresore e jetës së përbashkët (sh.VI-VIII), por edhe e konflikteve disa shekullore. Ato radhiten ndër shtyllat më të rëndësishme artistike të kulturës shpirtërore të shqiptarëve. Eposi i Kreshnikëve është jehonë poetike disa shtresore e jetës së përbashkët (sh.VI-VIII), por edhe e konflikteve disa

shekullore ndëretnike, e kacafytjeve dhe e përgjakjeve ilire-shqiptare me ardhësit sllavë të jugut në Iliri (Ballkan) e deri në ditët e sotme. Këngët tona rapsodike ishin frymëzim, për liri dhe Pavarësi. Ishin brumosje kulturore e kombëtare e brezit të ri të cilat u kënduan në kullat tona, odat tona festat dhe gëzimet tona gjatë gjithë jetës sonë. Këto këngë të bukura rapsodike ishin ushqim shpirtërorë dhe mbajtje të gjallë atdhedashurinë, kulturë, traditën, gjuhën dhe këngët tona të bukura që u kënduan me një stil të veçantë nga rapsodët tanë të mirënjohur që lanë gjurmë në jetën dhe kulturën tonë si: Dervish Shaqa, Sefë Mleqani, Salih e Feriz Krasniqi, Bajrush Doda, Augustin Uka, Sali Mani e shumë të tjerë."

Këngët tona rapsodike ishin brumosje kulturore e kombëtare e brezit të ri të cilat u kënduan në kullat tona, odat tona festat dhe gëzimet tona gjatë gjithë jetës sonë. Këto këngë të bukura rapsodike ishin ushqim shpirtëror dhe mbajtje gjallë atdhedashurinë, kulturë, traditën, gjuhën dhe këngët tona të bukura që u kënduan me një stil të veçantë nga rapsodët tanë të mirënjohur që lanë gjurmë në jetën dhe kulturën tone.

Ndryshimi i kohës, i mentalitetit, i gjeneratave e ka bërë të veten duke bërë që kopjimet e kulturave të huaja ti japin goditje të madhe shumë vlerave të kulturës sonë popullore dhe kjo gjë e varfëroj shumë folklorin tonë. Idetë e huazuara në mënyrë jo profesionale dëmtojnë shumë kulturën tonë popullore. Megjithatë folklori ynë i bëri ballë këtyre përpjekjeve dhe vazhdoi nder breza ta ruaj trashëgiminë tonë kulturore. Folklori ynë burimor e ka zanafillën bashkë me lindjen e lashtë të kombit tonë shqiptar. Kënga lindi si motiv për lirinë e këtij populli i cili u bëri ballë shumë pushtuesve.

Festivali Folklorik "I këndojmë Lirisë" që mbahet në Kline për të 23-tën herë më radhë edhe kësaj radhe pret Rapsodët e ardhur nga pjese të ndryshme të trojeve shqiptare.



FITUESIT E ÇMIMIT KRYESOR TË FESTIVALIT "MUJË KRASNIQI" NDËR VITE

Sadri HAXHAJ

Festivali folklorik "I Këndojmë Lirisë" që i kushtohet ditëlindjes së komandantit Mujë Krasniqi, tashme ka marrë karakter

mbarëkombëtarë, dhe nga viti në vit në të po marrin pjesë artistë nga e gjithë gjeografia shqiptare. Në çdo organizim të festivalit në skenën e tij, prezantojnë më shumë se 800 artistë të cilët para adhuruesve të folklorit po paraqesin vlerat autoktone të traditës sonë kombëtare. Çmimi kryesor i këtij festivali është çmimi "Mujë Krasniqi", të cilin për 23 vjet radhazi e kanë fituar artistë nga hapësira të ndryshme të trojeve shqiptare.

Kështu, në vitin 2001, çmimin "Mujë Krasniqi" e fituan këngëtarët klinasë Halit e Sinan Gashi nga

Klina. Në vitin 2002, fitues i këtij çmimi ishte Grupi polifonik "Bilbilat" nga Vlora, kurse, në vitin 2003, fitues shpallet SHKA "Zëri i Shalës" nga Mitrovica. Në vitin, 2004, çmimin "Mujë Krasniqi" e ka fituar rapsodi, Zymer Kryeziu, nga Mleqani i Malishevës. Në 2005-tën, SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi. Ndërkohë, në vitin 2006 çmimin kryesor të festivalit e ka fituar SHKA «Sharri», nga Hani i Elezit. Në vitin, 2007, fitues i çmimit, ishte Ansambli Qendra Kulturore Folklorike "Mirdita", derisa, në atë 2008, çmimi "Mujë Krasniqi" iu nda SHKA "Shotë Galica" Drenas. Pastaj në vitin 2009 fitues i festivalit shpallet, Grupi folklorik "Dervish Shaqa", Deçan, ndërsa në vitin 2010, çmimi kryesor "Mujë Krasniqi, mbetet në Klinë, ku fitues u shpallen Rapsodët Lekë e Gjokë Duhani. Në vitin 2011, fitues i çmimit "Mujë Krasniqi" shpallet Kurora Labe" nga Gjirokastra. Në edicionin e vitit 2012, fitues i çmimit ishte Ansambli "Rexhep Mitrovica" nga Mitrovica. Ndërkaq në vitin vijues 2013, pas një konkurrence të fortë, të cilën edhe juria e pranoi se e

kishte të vështirë të përcaktohej për më të mirin, çmimi i parë shkon në Drenicë, respektivisht në Skënderaj. Ishte viti 2014, kur vendin e parë e zuri SHKA nga Malësia e Tuzit.

Ndryshe, vjen viti 2015 kur vendin e parë e fiton SHKA "Ilirida" nga Shkupi. Kurse në vitin 2016 ishte Ansambli Autokton" Rugova "që rrëmbeu çmimin kryesor të festivalit "Mujë Krasniqi". Pason viti 2017, kur çmimin kryesor të festivalit e fitoj SHKA "Drenica" nga Skënderaj. Ndërkaq me 2018 fitues i festivalit ishte Ansambli "Shotë Galica" nga Drenasi. Në vitin 2019, fitues ishte Ansambli i Qytetit Obiliq. Për shkak të pandemisë Covid-19, në vitin 2020-2021, nuk është mbajtur festivali, gjë e cila ishte anuluar me vendim të asamblesë komunale të Klinës. Ndërkohë që në vitin pasues, 2022, fitues i çmimit, kryesor "Mujë Krasniqi" ishte Qendra Kulturore, "Anamorava" e Vitisë. Në vitin 2023, fitues ishte AKV "Mati" nga Shqipëria, nderisa në edicionin e fundit të vitit 2024, fitues i çmimit "Mujë Krasniqi" ishte AKV "Shotë Galica" nga Drenasi.

JURIA E FESTIVALIT

Juria profesionale e Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë" në përbërje: Prof. Xhevdet Gashi, kompozitor, kryetar jurie, prof. Suzana Drenica, anëtare dhe prof. Dr. Kushtrim Jakupi, anëtar, për tri net me radhë ka përcjellë, ansamblet, grupet, valltarët, rapsodët e instrumentistët që kanë performuar gjatë tri netëve në festival dhe i ka vlerësuar që të gjitha në mënyrë profesionale.



Nga festivali i vitit të kaluar i Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë"

NATA E TRETË KU KËNGA DHE VALLJA "PUSHTOJNË" SHESHIN "MUJË KRASNIQI"

Enver MALOKU

Në natën e tretë konkurruese të Festivalit "I Këndojmë Lirisë", Sheshi Mujë Krasniqi ishte mbushur me qytetarë që kishin ardhur për ta përcjellë mbrëmjen e ed tretë të Festivalit folklorik "I këndojmë lirisë". Edhe në këtë natë u shpalosen vlera të çmueshme të folklorit burimor. Secili grup, rapsodë, valltarë apo instrumentist përcolli vlera të artit, të kulturës e të traditës stërgjyshore, për t'i ruajtur si pasuri shpirtërore e kombëtare. Mund të thuhet se kjo natë ishte e "zjarrtë", me shumë emocione e përjetime të këngës e valles shqiptare të gjitha trojeve shqiptare. Ishte krijuar një kolorit veshjesh, kostumesh shumë mbresëlënës dhe tejet i pëlqyer nga spektatorët e shumtë që kishin mbushur sheshin Mujë Krasniqi. Nata e tretë kishte "rezervuar" grupe e ansamble të jashtëzakonshme me përformacën e tyre profesionale. AKV "Kastriotët", Ferizaj, AKV, Thesaret Labe", Tiranë, Rapsodi, Rrahman Pagarusha, AKV "Shotë Galica"-Drenas, AKV "Bajram Curri"- Prishtinë, Rapsodi Naim Sali Krasniqi, Drenoc-Malishevë, AKV "Deçani"-Deçan, AKV "Dedë Gjo Luli", Tuz-Mali i Zi, AKV "Agimi"-Prizren dhe rapsodi Emin Raci nga Diaspora. Të gjitha këto grupe, ansamble e valltarë u ndoqën me interesim nga spektatorët të cilët dhuruan duartrokitje të gjata. Të gjitha ishin mjaft interesante dhe me veshje tradicionale kombëtare. Edhe të artistët tjerë që u ngjiten në skenë, çoftë si rapsod apo valltarë ra në sy koloriti plot ngjyra të kostumeve të mrekullueshme. Edhe interpretimet ishin me plot gjallëri e jetë. Gjithçka, sikur dilte nga shpirti i popullit.

Kudo ku ka manifestime të ndryshme, në përvjetorë të heronjve, dëshmorëve të kombit apo ngjarje të tjera që lidhen me UÇK-në, çoftë edhe festivale, aty është Muhamet Kuka, me flamur të UÇK-së. Ashtu ishte edhe në festivalin folklorik "I këndojmë lirisë në Klinë. Gjatë tërë kohës ne nderim qëndroi me flamur në dorë. Ai kishte lënë Amerikën dhe kishte ardhur për tu inkuadruar në UÇK.

Në mbyllje të Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë", ndahen çmime e mirënjohje të tjera për ata që u ngjiten në skenë për tri netë me radhë. Prof. Dr. Zymer U. Neziri, epikolog, kryetar i jurisë profesionale, e cila me profesionalizëm të lartë përcolli artistet, ansamblet, rapsodët, valltarët e instrumentistet. Neziri në emër të jurisë profesionale paraqiti vlerësimin e saj, si dhe kush mori çmimet e festivalit. Ai, me këtë rast tha: "Të nderuar të pranishëm, përshëndetje të gjithëve!

Përshëndetje kryetar i Klinës, prof. dr. Zenun Elezaj, familje e Mujë Krasniqit dhe fort i nderuar baca Halil, familje të dëshmorëve, përfaqësues të pushtetit qendror e lokal, komandatë, invalidë e ushtarë të UÇK-së, veprimtarë të Lëvizjes Kombëtare të shumë brezave, intelektualë dhe banorë të Lugut të Drinit, të Lugut të Leshanit, të Drenicës e të Llapushës, si dhe ju, rreth treqind artistë popullorë nga shumë vise të Atdheut, ju përshëndes për zemërsisht edhe në emër të Jurisë së festivalit folklorik "I këndojmë lirisë", Haki Mulliqi, koreograf, dhe Burim Krasniqi, producent.

Festivali, i 22-ti me radhë, i organizuar si përherë me shumë kujdes, u mbyll me sukses. Edhe sivjet na bashkoi kënga epike për Mujë Krasniqin, i shquar nga brezi i Adem Jasharit me shokë, i famshëm në historinë më të re të Kosovës dhe i të gjitha viseve tona. Këtu ishin, gjatë tri netëve, edhe brezat e tjerë të lirisë, tashmë personazhe epike heroike të disa shekujve të fundit, nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu e deri te dëshmorët dhe heronjtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Këtu ishin edhe këngët për plisin e bardhë me rreth tre mijë vjet moshë, ishte shqiponja me dy krerë, e dëshmuar ndër ilirë që 27 shekuj, por ishte edhe flamuri kombëtar i vitit 1444, ndër më të vjetrit në Evropë", u shpreh Neziri. Ai vlerësoi edhe tekstet e këngëve, zërin e rapsodëve, veshjen, koreografinë, grupin më komplet, e të tjera.

"Në këtë skenë ishin tekstet epike dhe zëri burrëror i rapsodëve për bëmat heroike dhe për ngjarjet e mëdha të lirisë së Atdheut. Pra, këtu ishin rreth shtatë shekuj përpjekje e sakrifica. Ishte këtu edhe lirika jonë shumë e njohur në kërcimet vallnisht, krahas atyre të epikës sonë të famshme. Ishin këtu edhe veshjet tona kombëtare, si nga Veriu, ashtu edhe Jugu. Disa sosh, vërtet e kanë vendin në Listën e UNESCO-s. I patëm edhe veglat e vjetra muzikore tradicionale, nga fyelli e bishnica dhe deri te tupani e defi, çiftelia e sharkia etj.

Kemi pasur këtu edhe tekste tradicionale të këngëve, por kemi pasur edhe shumë tekste të reja, që kërkojnë kujdes të duhur nga hartuesit e tyre. Kujdes nevojitet edhe në punën koreografike, sepse tradicionalja duhet të ruhet dhe të mbrohet.

vijon në faqën 22

Të nderuar të pranishëm, në fund, para se t'i dëgjoni emrat e fituesve të sivjetmë, në emër të Jurisë së Festivalit, urime të përzemërta edhe për Ditën e Çlirimit të Klinës, për të cilën sakrifikoi jetën heroj ynë, Mujë Krasniqi me brezin e vet të Adem Jasharit, komandant legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, theksoi Prof.Dr. Zymer Neziri, në emër të jurisë profesionale. Ai paraqiti fituesit e festivalit dhe çmimet që ndahen këtu.

2. Vendi i dytë: Ansambli i qytetit “Obiliq”, Kastriot (Obiliq)

3. Vendi i tretë: AKV “Anamorava”, Viti

Çmimi “Mujë Krasniqi”: SHKA “Shotë Galica”, Drenas. Shoqëria kulturore artistike “Shotë Galica”, Drenas, fituese e vendit të parë edhe më 2008 e 2018 në festivalin “I këndojmë lirisë”, në Klinë, edhe sivjet, më 2024, pati në skenë një paraqitje jashtëzakonisht mbresëlënëse në këtë festival të XXII të radhës.

Vendi i dytë: Ansambli i qytetit “Obiliq”, Kastriot (Obiliq). Ansambli i qytetit “Obiliq”, Kastriot (Obiliq), fitues i vendit të parë më 2019, në festivalin “I këndojmë lirisë”, në Klinë, edhe sivjet, më 2024, pati në skenë një paraqitje shumë mbresëlënëse në festivalin XXII të radhës. Veshja kombëtare e vajzave dhe e djemve të këtij ansambli ishte shumë e bukur. Rapsodët Vesel Mjeku dhe Luan Zogjani, me këngën “Unë quhem Ilir”, me zërin e shkëlqyeshëm dhe me tekstin fort të mirë, publiku i priti me duartrokitje. Edhe në valle dukeshin bukur, vajza e djem, me ato veshje tërheqëse dhe me lojën brilante. Grupi i vajzave ishte i dalluar. Rapsodi Binak Prenku, me sharki, me një tekst të ri, e këndoi bukur këngën “Mos harro Kosovë”. Paraqitja e ansambllit të qytetit “Obiliq”, Kastriot (Obiliq) u vlerësua dhe u shpall nga Juria fitues i vendit të dytë në festivalin “I këndojmë lirisë”, më 2024.

Vendi i tretë: AKV “Anamorava”, Viti. Ansambli kulturor artistik “Anamorava” i krahinës etno-gjeografike të Anamoravës u prit me duartrokitje në këtë festival. Njohësit e njohin si krahinë e dalluar e valles së burrave të Anamoravës dhe të Karadakut. Ky ansambël, fitues i vendit të parë më 2022, pati në skenë një paraqitje mbresëlënëse. Ra në sy sidomos veshja kombëtare. Vallëzimi kolektiv doli i pëlqyer për publikun, deri te loja me plakun e rrëxuar, që ende nuk i ndahet lojës, por është pikë që dëshmon se atje vallëzojnë të gjithë brezat. “Vallja e baresh-ës”, me koreografi të Feim Lekës dhe me muzikën e Ylber Asllanit, u prit me duartrokitje. Ashtu u prit edhe pika muzikore “Dardane vjetër” e Florin Lumës dhe e Almirë Musliut. Me “Dasmën e Anamoravës”, ky ansambël, i drejtuar nga Arianit Hetemi, që e zuri vendin e tretë, e përfun-doi programin e vet të paraqitjes në festivalin XXII “I këndojmë lirisë”, në Klinë, 2024.



FESTIVALI I NJË RËNDËSIE TË VEÇANTË PËR VLERAT KULTURO-ARTISTIKE DHE TRADITAT BURIMORE MBARËKOMBËTARE

Bedri MORINA



Ahmet Krasniqi, ish drejtor komunal i Kulturës dhe Sportit në periudhën prej vitit 2010 e deri në vitin 2013, ndonëse ka kaluar një kohë më tepër se një dekadë kujton organizimin Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë" në ato vite dhe flet me krenari për mbajtjen e festivalit. Ai tregon se janë përpjekur që në festival të sjellin ansamble, grupe, rapsodë, valltarë nga të gjitha trojet

shqiptare. Ai ndjehet krenar që ka qenë pjesë e festivalit dhe kanë arritur që në Klinë të sjellin vlera të mirëfillta folklorike, sepse këtu u është kënduar dhe vallëzuar heronjve, Komandantit legjendar Adem Jasharit, Komandantit Mujë Krasniqit-Kapuçit, e të tjerëve që dhanë jetën për lirinë që ne sot e gëzojmë.

Si e kujtoni atë kohë të mbajtjes së këtij Festivali?

- Për mua ishte një privilegj të jem drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport dhe të jem pjesë e organizimit të Festivalit Folklorik "I këndojmë lirisë"- Kapuçit

Gjatë periudhës time si drejtor i DKRS-së janë mbajtur katër Festivale Folklorike.

E kujtoj si një ngjarje me rëndësi të madhe kulturo-artistike që në vete kujton vlerat dhe traditat burimore mbarëkombëtare të ruajtura me fanatizëm dhe të kultivuara ndër breza. Për organizimin dhe mbarëvajtjen e Festivalit Folklorik formohej Këshilli Organizativ. Ky këshill emëronte Kryetarin e Këshillit dhe grupet punuese. Grupet punuese ishin mjaft të përgjegjshme në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi, duke e ditur rëndësinë e Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar, që u jemi falënderues.

Në kuadër të Festivalit janë mbajtur edhe shumë aktivitete të ndryshme si: Orë letrare, ekspozita, tribuna shkencore- historike e aktivitete sportive, ku për të gjitha keto janë nda shpërblime.

Çfarë ishin vlerat e prezantuara nga pjesëmarrësit! Gjatë atyre viteve vlerat e prezantuara nga shoqëritë kulturo- artistike ishin në nivel shumë të lartë dhe profesional.

- Para se të prezantonin këto shoqëri bëhet përzgjedhja e tyre nga drejtorja artistike -profesionale e cila dilte në terren dhe e bënte përzgjedhjen e këngëve dhe valleve.

Në Festivalin Folklorik janë prezantuar shumë shoqëri kulturo-artistike me këngëtarë dhe valltarë shumë profesionistë, duke prezantuar, këngët e vallet me përmbajtje kombëtare të atyre regjioneve - trevave që paraqiteshin me shumë vlera e përmbajtje autoktone! Si të duket tash: Festivali Folklorik "I këndojmë lirisë"?

- E di që tani Festivali ka marrë drejtimin e vet të organizimit dhe është bërë një përvojë në organizime të tilla, për çka dhe i përgëzoj të gjithë ata që mbarëvajnë organizimin e Festivali Folklorik "I këndojmë lirisë", që tani është bërë tradicional.

Çfarë do të thotë për Klinën mbajtja e një Festivali të tillë mbarëkombëtar?

-Për mbajtjen e Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar për Klinën do të thotë shumë dhe është një vlerë e madhe kombëtare.



"NË ÇABIQ E N'SHQIPTARI, KA ME U KËNDUE KÂNGA PËR TY" KUSHTUAR MUJË KRSANIQIT- KOMANDANT KAPUÇIT

Mustafa BEQIRI

Mujë Krasniqi, ëndrrën tuaj dhe të shokëve tu të idealit për liri,



tani ne po e gëzojmë. Mujë Krasniqi, në shenjë nderimi, respekti dhe mirënjohjeje ndaj jetës dhe veprës suaj dhe të shokëve tu, për çlirimin e vendit dhe lirinë e popullit të Kosovës, që 23 vjet komuna e Klinës organizon Festivalin Folklorik Mbarëkombëtar "I Këndojmë Lirisë, Mujës dhe gjithë dëshmorëve të kombit"

Mujë Krasniqi, sot në fshatin tuaj të lindjes në Çabiq, ka festë, këtu kanë ardhur bashkëluftëtarët

tu të luftës; të pushkës e të penës, shokë, miq e dashamirë nga të gjitha anët e shqiptarisë për t'u nderuar, për t'u kujtuar, kënduar e aktruar, veprën tuaj sublime, e cila sot e për mot, do i bëjë nder fshatit tuaj, Çabiqit dhe gjithandej

Kosovës e më gjerë..!

O, Mujë Krasniqi..!

"Sa t'ketë Hanë, e sa t'ketë Diell.

Sa t'ketë yje, lart në qiell.

Në Çabiq e n'shqiptari.

Sa t'jetë jeta me lavdi,

Ka me u këndue kânga për ty..!"

Mujë Krasniqi, komandant Kapuçi, heroizmi juaj dhe i shokëve tu të idealit për çlirimin e këtij vendi dhe lirinë e këtij populli, sot e për mot, do të reflektojë në historinë e lavdishme të popullit shqiptarë..!

, të cilët në shpirt dhe në zemër e kanë lirinë, prandaj edhe e thonë:

-E bëj vdekjen si me lé..!

-Mujë Krasniqi, ju u flijuat në fushën e nderit, për të mbetur i pavdekshëm gjithmonë e jetë..!

-Sot shtati juaj, lapidari juaj i skalitur në bronz, po u bën roje nderi qytetarëve të Klinës dhe gjithë popullit të Kosovës..!

-E shtrenjtë është liria e Kosovës, i shtrenjtë është gjaku i dëshmorëve dhe e lavdishme është vendosmëria dhe historia e luftëtarëve të UÇK-së..!

-Mujë Krasniqi, Ju dhe bashkëluftëtarët tu, luftuat, ndërruat jetë, për të jetuar, për t'u simbolizuar, për t'u kujtuar e respektuar për jetë e mot në historinë e lavdishme të popullit shqiptarë..!

-Sot pavdekësia juaj po ecën përkrah lirisë, thirrjes së cilës i

qëndruat gjithmonë gatitu, për çka neve sot e për mot, na detyron dhe na obligon, që t'u jemi mirënjohës për jetë e mot..!

-I paharruar dhe i përjetshme, do jetë kujtimi për Ju dhe për të gjithë ata, të cilët e derdhën gjakun për atë, të cilën sot, Ne po e gëzojmë - LIRINË, të cilën ky popull e ka ëndërruar dhe e ka pritur me vite e me shekuj..!

-Lavdi jetës dhe veprës suaj heroike..!

-I lehtë, u qoftë dheu i kësaj toke, të cilën

e ujitet me gjakun tuaj të dëlirë..!

Sa shumë lart Mujë, u lartësove,

dëshmor kombi, sot u këndove.

Historinë me gjak e shkrove,

rrugë e sheshe i madhështove..!

Por si qiri, u shkri ky burrë

Që s'merr frymë, por që s'vdes kurrë..!

-Lavdi për jetë e mot, gjithë dëshmorëve

të kombit, të të gjitha kohërave,

të cilët lirisë së popullit të Kosovës, i dhanë emër..!

Në kujtim të rapsodëve që nuk jetojnë më **ALI KRASNIQI, OSMAN E BRAHIM SEFA DHE HASHIM SHALA, E TËRË JETA E TYRE ME KËNGË**

Sadri HAXHAJ

Shumë rapsodë kënduan këngë të ndryshme atdhetare, duke mbajtur gjallë aspiratat kombëtare për liri nga okupatorët e shumtë që synuan pushtimin e trojeve shqiptare, nuk jetojnë më. Por ata kan lënë pas vetës një thesar të çmuar të këngëve të ndryshme rapsodike të kënduara me aq mjeshtri. Disa nga ta morën pjesë edhe në festivalin folklorik "I Këndojmë Lirisë", siç ishte Ali Krasniqi, Osman e Brahim Sefa dhe Hashim Shala. Ata, me shumë përkushtim dhe dashuri i kënduan folklorit tonë burimor duke lënë pas vetës një kolorit të çmuar këngësh të cilat edhe sot këndohen me shumë dashuri e pasion.

Populli ynë, i është mirënjohës këtyre rapsodëve që lanë pas vetës një trashëgimi të këngës së mirëfilltë folklorike, të cilat sot këndohen dhe do të këndohen brez pas brezi nga pasardhësit e tyre dhe rapsodët tjerë të popullit tonë.



Intervistë me Ismet Krasniqin

FESTIVALI FOLKLORIK "I KËNDOJMË LIRISË", VLERË E LARTË E FOLKLORIT BURIMOR

Enver MALOKU



Ismet Krasniq-Lala, është njëri ndër themeluesit e festivalit "I Këndojmë Lirisë", që tashmë mbahet çdo vit, me 6, 7 e 8 qershor. Ai flet si e nisën këtë festival, vështirësitë që kishin atëherë, entuziazmin, vlerat e festivalit dhe rrugëtimin e tij të deritashëm.

REVISTA LYRA: Çfarë të kujton nisja e festivalit folklorik "I këndojmë lirisë"?

Ismet Krasniq-Lala: Pas luftës se fundit në Kosovë kur çdo gjë ishte e shkatërruar nga okupatori serb edhe kultura kishte pësuar shumë gjatë këtyre viteve të okupimit, por kurrë qiriri i aktiviteteve kulturore nuk u shua. Pas luftës në Kosovën e lirë u krijua frymë e re e entuziastëve të kulturës. Prandaj nga njerëzit artdashës të Klinës u dha një ide që të organizohet një festival i folklorit, duke e pasur parasysh se Dukagjini dhe Llapusha janë treva ku

idesë së disa intelektualëve, krijuesve, folkloristëve, regjisorëve dhe artdashësve, u përpunua ideja që festivali në Klinë të jetë më i veçantë prej festivaleve tjera në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare. Nga Dibran Fylli u dha ideja që festivali të mbahet më 6 qershor në ditëlindjen e Komandantit të UÇK-së, Mujë Krasniqit. Dëshmorët e kombit e kanë ditën e lindjes e nuk kanë ditë të vdekjes. U formua Këshilli Organizativ, i cili nxori aktet normative mbi organizimin e festivalit dhe të gjitha rregulloret përcjellëse dokumente edhe sot me vlerë të hartuara nga juristi Gani Morina. Si dhe u hartua skenari për organizimin e festivalit. Kryetar i Këshillit Organizativ u zgjodh Dibran Fylli, i cili njëkohësisht ishte edhe ideatori i festivalit. U mor vendim që festivali të emërohet me emrin Festivali Folklorik "I KËNDOJMË LIRISË". U vendos të mbahet më 5 dhe 6 qershor 2001. Festivali do të jetë gjithëkombëtar dhe do të jetë tradicional, i cili do të organizohet në shenjë të nderimit të rapsodëve dëshmorë, Mujë Krasniqit dhe Beqir Gashit, si dhe do t'u këndohet në festival të gjithë dëshmorëve të kombit.

Revista LYRA: Si ishin kushtet e fillimit, pasi që po sa kishim dal nga lufta?

Ismet Krasniq-Lala: Është e kuptueshme se përnjëherë pas lufte kur gjithçka ishte e shkatërruar nga okupatori serb, kur njerëzit nuk kishin kulm mbi krye por vullneti ishte i madh për të organizuar e përkrah festival folklorik që madhështon luftën e UÇK-së, për përjetësimin e gjithë dëshmorëve e martirëve që kishin rënë në luftën për liri, të përjetësohen në këngë nga rapsodët e të gjitha trevave shqiptare.

Në fillim kushtet nuk ishin të mira qoftë nga infrastruktura e shtëpisë së kulturës, ku mbahej festivali si dhe nga mungesa e mjeteve financiare. Këto vështirësi u tejkaluan me përkrahjen nga biznese të Klinës. Vullnetarisht u pritën festivalistët nga pronaret e restoranteve, kafeneve, gjellëtoreve popullore dhe shtruan sofrën me

mundësi të vogla e me zemër të madhe. Kur të përkrah populli tejkalohen të gjitha pengesat.

REVISTA LYRA: Si e vlerëson rrugëtimin e festivalit, mbi 23 vjet?

Ismet Krasniq-Lala: Një rrugëtim i gjatë, plot sfida por edhe plot suksese. Nga shumë gazeta e Radio Televizione festivalin "I këndojmë lirisë" e kanë vlerësuar, si festivali mirë i organizuar, me vlera artistike e me një përcjellje të madhe nga publiku. Në fillim mbi 95% në festival kanë dominuar këngët e vallet epike me tematikë nga luftërat e shqiptarëve për liri e veçmas këngët me tekste kushtuar luftës së UÇK-së. Ndërsa sot sipas asaj çka unë kam përcjell mund të jenë 50 % me 50% epiko-lirike.

REVISTA LYRA: Çfarë mendoni për vlerat folklorike të prezantuara në festival?

Ismet Krasniq-Lala: Meqenëse për çdo vit Këshilli Organizativ dhe drejtorja i Festivalit emëron jurinë profesionale që i përcjell pikat konkurruese dhe në fund i ndanë çmime për më të mirët. Falënderohen pjesëmarrësit dhe vlerësohen për paraqitje të suksesshme në skenën e festivalit. Kjo do të thotë se festivali ka vlera të larta.

Edhe unë e kam të njëjtin mendim si person që e kam përcjell festivalin nga afër dhe kam bërë përzgjedhjen e pikave konkurruese në terren në cilësinë e drejtorit artistik dhe të plakut të festivali, konsideroj se në festival paraqiten grupet dhe individët me përgatitje të mirë.

Vlerësime pozitive ka edhe nga profesionistë, qoftë nga juria apo nga ata që e përcjellin festivalin nga afër, si Prof. Dr. Zymer Neziri, Ermir Dizdari, Ramazan Bogdani, Rexhep Munishi, Deli Metaliaj, Sejmen Gjokoli, Vesel Zeka, Prend Buzhala, Muzaferre Mustafa, Minire Fetahu etj.

Festivalit urime në rrugëtimin e tij, pjesëmarrësve suksese!

Kryetari i fshatit Çabiq Sokol Krasniqi

ÇABIQI E FESTON DITËLINDJEN E BIRIT TË TIJ MUJË



KRASNIQIT

Sadri HAXHAJ

"Sot është ditëlindja e komandantit legjendar Mujë Krasniqi-Kapuçi, me të cilin kalova pjesën më të madhe të jetës. Ishin momente që nuk harrohen kurrë ngase nuk jemi ndarë as ditë, as natë si në luftë ashtu edhe në kohë të ndryshme".

Kështu e kujton figurën e Komandant Mujë Krasniqit, njëri nga bashkëluftëtarët e tij Sokol Krasniqi i cili njëherësh është edhe kryetar i fshatit Çabiq.

"Mujën e kishte falur Zoti të madh, në njërën anë si artist duke i dhuruar një zë si të bilbilit dhe shumë melodik ku bashkë me Beqir Gashin mbanin gjallë moralin luftëtarëve të lirisë dhe në anën tjetër një trimëri të rrallë dhe një zgjuarsis e cila i shërbeu frymëzim për themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

"Sot kur po festojmë ditëlindjen e tij, jemi të lumtur që këtë ditëlindje e feston gjithë shqiptaria. Muja i këndoi gjithë heronjve të kombit dhe në fund u bë vet hero që ra për të mos vdekur kurrë duke u kujtuar brez pas brezi si një nga kolosët e luftës për liri.

Krenohemi që e patëm, që jetuam në kohën e tij dhe jam i lumtur që shumë këshilla mësuam nga ai. Të flasësh për Mujën terë jetën është pak, s'kam fjalë ta përshkruaj sepse ai ishte vet i madh, veprat e tij ishin më të mëdha se fjalët tona", thotë Krasniqi

Muja siç ishte vet i kishte edhe shokët i kishte edhe vëllezërit që nuk u nda asnjëherë nga ta. Ai kishte Aliun, trim i cili eci hapave të tij deri sa ra në altarin e lirisë bashkë me Mujën dhe Beqir Gashin.

Ai ra heroikisht duke lënë pas një histori për popullin shqiptar, ku me këngën, pushkën dhe gjakun e tyre e shkruan vetë historinë më të re të kombit tonë.

Sokol Krasniqi, ka shprehur fjalë miradije për komunën e Klinës e veçmas për kryetarin Zenun Elezaj sipas të cilit po u qëndron pranë, duke u ndihmuar që ky festival të organizohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Pa harruar që ti falënderojë banorët e fshatit Çabiq që me bujarinë dhe mirëpritjen e tyre që nga themelimi i festivalit



Në Festivalin Folklorik "I Këndojmë Lirisë"

JEHON "JEHONA E DUKAGJINIT"

Sadri HAXHAJ



Ansambli i Këngëve dhe i Valleve "Jehona e Dukagjinit" nga Klina, vazhdon të jehojë në Festivalin "I Këndojmë Lirisë".

Drejtori i këtij ansambli, Daut Gashi, flet për Lyrën në lidhje me punën dhe aktivitetet që po bëjnë.

I themeluar në vitin 2019, ky ansambël bëri edhe hapjen solemne të festivalit "I këndojmë Lirisë" në Çabiq të Klinës, në vendlindjen e Komandantit Mujë Krasniqi dhe tregoi një paraqitje shumë dinjitoze për çka edhe u duartrokta nga adhuruesit e muzikës folklorike.

AKV "Jehona e Dukagjinit" ka marrë pjesë edhe në festivale të ndryshme kombëtare me ç'rast ka fituar edhe një mori çmimesh si një nga ansamblet më të mira në hapësirën shqiptare.

Drejtori Gashi, thotë se kanë marrë pjesë në festivalin "Eshkë e ndezur në Shkëlzen" në Deçan, derisa do të paraqitemi edhe për nder të "18 Qershorit" ditës së çlirimit të Klinës, ndërkohe që kemi pranuar ftesa të marrim pjesë edhe në festivale të tjera në Kosovë, Shqipëri dhe vise të tjera shqiptare.


"Në mënyrë që ky ansambël të vazhdojë të korrë suksese të njëpasnjëshme, apelon te institucionet komunale dhe ato qendrore që ta mbështesin AKV "Jehona e Dukagjinit", sepse pa mbështetje financiare e kemi vështirë të funksionojmë, thotë drejtori Gashi.

Ai ka përmendur edhe një mori çmimesh që ky ansambël ka fituar siç janë: çmimin "Zëri më i mirë i festivalit" në Komoran, që i kushtohet dëshmorit Xheladin Gashit-Plakut, pastaj në festivalin e Gjakovës ky ansambël ka fituar çmimin e publikut, ndërkohë që në Deçan kemi marrë çmimin "Grupi më i mirë i festivalit". Poashtu nga Puka morën tri çmime tjera. Ky ansambël, çdo ditë e më shumë po i sjell Klinës çmime të ndryshme për arritjet në prezantimin e këngëve dhe valleve folklorike.

OPINIONE

KUR KËNDOJMË PËR LIRINË, KUJTOJMË SAKRIFICËN

Arjon GASHI



Që nga viti 2012 Arjon Gashi, në formë të ndryshme është pjesëmarrës i Festivalit Folklorik "I Këndojmë Lirisë", qoftë si mysafir me këngë për dëshmorët apo në formë të ndryshme të organizimit të festivalit, si në Çabiq në hapjen e festivalit apo në tri netët e festivalit në sheshin "Mujë Krasniqi" në Klinë. Kjo ngjarje ka tejkaluar dimensionin e një festivali kulturor për t'u shndërruar në një simbol të kujtesës sonë kombëtare dhe të nderimit të atyre që dhanë gjithçka për lirinë tonë. Ky

festival mbahet për nder të komandantit legjendar Mujë Krasniqi, emri i të cilit është ngulitur thellë në historinë, ndërgjegjen dhe në zemrat tona. Për mua, pjesëmarrja në këtë festival nuk është vetëm një angazhim artistik apo kulturor, por një përjetim i brendshëm, një ndjenjë që më lidh fort me rrënjët e mia familjare dhe me të kaluarën tonë të lavdishme. Çdo herë që jam pjesë e tij, në çfarëdo forme qoftë – organizim, ndihmesë, ide, pjesëmarrje – e ndjej se po e nderoj jo vetëm një figurë të madhe kombëtare, por edhe gjakun e familjes sime, idealin që më është trashëguar brez pas brezi. Festivali "I këndojmë lirisë" është më shumë se një festival folklorik. Është një amanet. Është një kujtesë e gjallë që na rikujton se liria nuk ka ardhur vetvetiu, por është fituar me gjak, me qëndresë dhe me dashuri të madhe për atdheun. Dhe është përgjegjësi e brezit tonë që ta mbajë këtë kujtesë të gjallë, ta kultivojë, ta përcjellë më tutje, me zë, me këngë, me fjalë dhe me vepra. Unë e ndjej këtë përgjegjësi si nder, por edhe si borxh. Dhe sa herë që këndojmë për lirinë, në të vërtetë po i këndojmë historisë që është shkruar me emrin e Mujë e Ali Krasniqit dhe shumë bijve të këtij vendi, që sot prehen në altarin e lirisë,

15 çmimet e ndara në Festivalin Folklorik "I Këndojmë Lirisë"

1. Çmimi "Mujë Krasniqi" "Drenica" Skenderaj
2. Ansambli Autentik "Rugova"
3. Vendi i tretë SHKA "Malësori", Gjonaj, Has
4. Ansambli më i kompletuar AKV Qyteti Obiliq
5. Çmimi i publikut Fenix, Zvicër
6. Veterani i festivalit Grupi Harea
7. Instrumentisti më i mirë Klarinetisti nga Berati
8. Interpretuesi më i mirë Ismet Demaj
9. Valltari më i mirë Lorik Sylejmani
10. Grupi më i mirë i rapsodëve Grupi nga Mirdita
11. Dueti më i mirë Naim Krasniqi dhe Salih Bytyçi
12. Zëri më i mirë i festivalit Samir Krasniqi
13. Veshja më autentike Thesaret Labe, Grupi polifonik, Tiranë
14. Orkestra më e mirë folklorike "Kastriotët", Ferizaj
15. Vallja më e mirë koreografike "Anamorava", Viti

Sivjet juria profesionale ndau edhe çmimin "Debutanti i festivalit", që ju nda Grupit të Vajzave, Opojë.

FESTIVALI PËRMES FOTOVE - ÇABIQ



NATA E PARË



NATA E DYTË



NATA E TRETË



23 VJET FESTIFAL

Që nga themelimi i festivalit folklorik tash e 25 vite nuk u ndal kurrë jehona e këngëve folklorike, madhështia e valleve tradicionale dhe promovimi i vlerave kulturore e kombëtare përmes këtij festivali, që mbledh në qytetin e Klinës ansamble, grupe artistike, këngëtarë, rapsodë e mysafirë nga të gjitha trevat shqiptare. Festivali Folklorik "I Këndojmë Lirisë" mbahet për të nderuar luftën heroike të Komandant Mujë Krasniqit "Kapuçit", në fshatin e tij të lindjes në Çabiq dhe realizohet për tri netë me radhë në Sheshin "Mujë Krasniqi" në Klinë me datat 6, 7, dhe 8 qershor me një program të pasur artistik.

Që nga themelimi me vendim të Kuvendit Komunal të Klinës festivali realisht këtë vit shënon 25 - vjetorin e tij, mirëpo si shkak i pandemisë globale gjatë viteve 2020-2021, nuk u realizua.

Festivali ka karakter garues, në kuadër të të cilit ndahen 15 çmime, ku kryesori është Çmimi "Mujë Krasniqi", pastaj vendi i dytë dhe i tretë. Si dhe ndahen edhe çmime të tjera si: grupi më i kompletuar, veterani i festivalit, instrumentisti/ja më i mire, koreografia më e mirë, veshja më autentike etj.

FESTIVALI FOLKLORIK "I KËNDOJMË LIRISË"

Fituesit e Çmimit kryesor
"Mujë Krasniqi" ndër vite

2001 - Halit e Sinan Gashi nga Klina
2002 - Grupi Polifonik "Bilbilat" nga Vlora
2003 - SHKA "Zëri i Shalës" nga Mitrovica
2004 - Rapsodi Zymer Kryeziu nga Mleqani i Malishevës
2005 - SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi
2006 - SHKA "Sharrë" nga Hani i Elezit
2007 - Ansambli Qendra Kulturore Folklorike "Mirdita" nga Mirdita
2008 - SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi
2009 - Grupi folklorik "Dervish Shaqi" nga Deçani
2010 - Rapsodët Lekë e Gjokë Duhani nga Klina
2011 - "Kurora Labe" nga Gjirokastra
2012 - Ansambli "Rexhep Mitrovica" nga Mitrovica
2013 - SHKA "Drenica" nga Skenderaj
2014 - SHKA "Dedë Gjolluli" nga Malësia e Tuzit
2015 - SHKA "Ilirida" nga Shkupi
2016 - Ansambli autokton "Rugova" nga Peja
2017 - SHKA "Drenica" nga Skenderaj
2018 - SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi
2019- Ansambli i Qytetit "Obiliq" – Obiliq
2022- Qendra Kulturore "Anamorava" – Viti
2023- AKV "Mati" Shqipëri
2024- SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi



KOMUNA KLINË

6,7,8 QERSHOR
KLINË - KOSOVË

Edicioni i 23 - të



FESTIVALI FOLKLORIK "I KËNDOJMË LIRISË"

6, 7, 8 QERSHOR 2025

Festivali Folklorik "I Këndojmë Lirisë" mbahet në
përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Klinës
prof. dr. Zenun Elezaj

PROGRAMI – Nata e Parë Ora 19:00

6 QERSHOR 2025

1. AKV "Jehona e Dukagjinit", Klinë (Jashtë konkurrimit)
2. AKV "Malësori", Has
3. AKV "Flaka e Llapit", Podujevë
4. Grupi i Rapsodëve nga Mleqani
5. AKV "Opoja", Opojë
6. AKV "Zëri i Kamenicës", Kamenicë
7. AKV "Bilbilat e Pashtrikut"
8. Rapsodi Shefqet Gashi
9. AKV "Selman Kadria", Istog
10. Rapsodët Bedri Karaxha me grup
11. AKV "Karadaku" Gjiilan

PROGRAMI – Nata Dytë Ora 19:00

7 QERSHOR 2025

1. AKV "Isa Boletini", Rogovë
2. Studio Artistike "Fenix", Diasporë - Zvicër
3. Rapsodi Emin Raci
4. AKV "Hareja", Prizren
5. AKV "Dedë Gjon Luli", Tuz
6. Rapsodët Nuredin e Fatmir Meta
7. AKV "Quperlinjë e Beratit", Berat
8. Grupi Kqira, Pukë
9. Rapsodët nga Deçani
10. AKV "Qyteti i Obiliqit", Obiliq
11. AKV "Drenica", Skenderaj

PROGRAMI – Nata e Tretë Ora 19:00

8 QERSHOR 2025

1. AKV "Kastriotët", Ferizaj
2. AKV "Duflla" nga Shkupi, Maqedonia e Veriut
3. Rapsodi Naim Krasniqi dhe Salih Bytyqi
4. Grupi "Besa", Shosh - Shkodër
5. Grupi nga Mirëdita - Mjeshtri i Madh
6. Arton Zogaj me grup
7. AKV "Thesaret Labe", Tiranë
8. AKV "Shotë Galica", Drenas
9. Vëllezërit Petrit e Feriz Krasniqi, në çifteli Blerim Krasniqi
10. Ansambli "Rugova", Pejë
11. AKV "Anamorava", Viti





LYRA

Festivali Folklorik “I Këndojmë Lirisë”

mbahet në përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Klinës

prof. dr. Zenun Elezaj



**KOMUNA
KLINË**

Edicioni 23

FESTIVALI FOLKLORIK “I KËNDOJMË LIRISË”



**6,7 dhe 8
Qershor**

2025

**EDICIONI
23**

**FESTIVALI
FOLKLORIK
“I KËNDOJMË LIRISË”**



**6, 7, 8
Qershor**

2025



**KOMUNA
KLINË**

RTK

**RADIOTELEVIZIONI
I KOSOVËS**



KLINA INFO

**REVISTË PERIODIKE E FESTIVALIT FOLKLORIK
“I KËNDOJMË LIRISË”**

<https://kk.rks-gov.net/kline>